



Kuadri i Investimeve në Ballkanin Perëndimor
Instrumenti i Përgatitjes së Projekteve në Infrastrukturë
Asistenca Teknike 6 (IPF6)
TA 2016032 R0 IPA

WB16-ALB-TRA-01
Projekti i Zbatimit për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore
Vorë – Hani i Hotit
Shqipëri
PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT
rishikuar Korrik 2022



IPF6 Consortium

KUADRI I INVESTIMEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR (WBIF)

Asistenca Teknike për Përgatitjen e Projekteve në Infrastrukturë 6 (IPF6)

TA 2016032 R0 IPA

Titulli i nën-projektit

Projekti i Zbatimit për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani i Hotit, Shqipëri

WB16-ALB-TRA-01

PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT

Varianti	Data	Përgatiti	Kontrolluar	Aprovuar	Komente
V.01	Mars 2021	Ardian Shehu Ledina Gjijnuri Taulant Bino	Hector Martinez	Aristides Karlaftis	Draft për komente
V.02	Korrik 2021	Ardian Shehu Ledina Gjijnuri Taulant Bino	Hector Martinez	Aristides Karlaftis	Miratuar
V.03	Korrik 2022	Abkons	Redion Biba/ Eriola Kurti		Draft i rishikuar për komente

Instrumenti i Përgatitjes së Projekteve në Infrastrukturë (IPF) është një instrument i asistencës teknike të Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF), një iniciativë e përbashkët e Bashkimit Evropian, institucioneve financiare ndërkombëtare, donatorëve dypalësh dhe qeverive të Ballkanit Perëndimor e cila mbështet zhvillimin socio-ekonomik dhe anëtarësimin në BE të gjithë Ballkanin Perëndimor përmes sigurimit të financimit dhe asistencës teknike për investime strategjike në infrastrukturë. Kjo asistencë teknike financohet me fondet e BE-së.

PERMBAJTJA

1	HYRJE.....	9
1.1	HISTORIKU.....	9
1.2	STUDIMI I VNMS-SË DHE DOKUMENTI AKTUAL.....	10
1.2.1	<i>Procesi i VNMS-së dhe PMMS</i>	10
1.2.2	<i>Paketa e kërkuar e studimit të VNMS për Projektin</i>	11
1.3	QËLLIMI I KËTIJ DOKUMENTI	11
2	PLANI I MENAXHIMIT TË MJEDISIT.....	12
2.1	QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT	12
2.2	DETYRAT/ROLI DHE PËRGJEGJESITË	12
2.2.1	<i>Zhvilluesi dhe përgjegjës të tjerë të projektit</i>	12
2.2.2	<i>Kontraktuesi</i>	12
2.2.3	<i>Rishikimi dhe amendimi/perditesimi i PMM</i>	14
2.3	PLANI I MENAXHIMIT TË MJEDISIT	14
2.3.1	<i>Permbajtja e planit të menaxhimit mjedisor dhe social</i>	14
2.3.2	<i>Strategjia e masave zbutëse</i>	15
2.3.3	<i>Plane specifike menaxhimi</i>	15
3	PLANI I MONITORIMIT TË MJEDISIT	34
3.1	LINJAT KRYESORE TË PLANIT TË MONITORIMIT TË MJEDISIT	34
4	VEPRIMTARITË KRYESORE TË PLANIT TË MENAXHIMIT E MONITORIMIT TË MJEDISIT	34
4.1	MASAT KRYESORE PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE NË MJEDIS	34
4.2	AKTIVITETET KRYESORE MONITORUESE	34

Lista e tabelave

Table 2.1_Lista e nen-planeve specifike të propozuara nga Konsulenti gjatë përgatitjes së VNM-se	15
Table 3.1_Përmbledhje e masave zbutëse gjatë parandertimit dhe ndërtimit	36
Table 3.2_Përmbledhje e masave zbutëse gjatë funksionimit dhe mirëmbajtjes së hekurudhës.....	67
Table 3.3_Veprimtaria monitoruese gjatë fazave të parandertimit dhe ndërtimit të hekurudhës.....	85
Table 3.4_Veprimtaria vëzhguese/monitoruese gjatë funksionimit dhe mirëmbajtjes së hekurudhës....	99

Lista e figurave

Figure 1.1_Skema e rrjetit të linjës hekurudhore shqiptare	9
--	---

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE TË NËN-PROJEKTIT

VEPRIMI	Zbatimi i nën-projektit
KODI I PROJEKTIT	WB16-ALB-TRA-01
PËRFITUESI	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjise, Shqipëri Hekurudha Shqiptare
SEKTORI	Transport
VENDI	Shqipëri
Institucioni financiar kryesor	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Miratimi nga AK	12 dhjetor 2018
Data e fillimit	20 dhjetor 2018
Data e përfundimit	25 qershor 2021

LISTA E SHKURTESAVE

Shkurtesa	Përshkrimi
m.n.d.	mbi nivelin e detit
AK	Autoriteti Kontraktues
AIC	Korridori Adriatiko – Jonian
AKM	Agjensia Kombëtare e Mjedisit
AKPT	Agjensia Kombëtare e Planifikimit të Territorit
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
Gg	10 ⁹ g (njësia ekuivalente për të matur CO ₂)
GHG	Gazrat Serë (emetimet)
HEC	Hidrocentral
HSH	Hekurudha Shqiptare
IAP	Gazsjellësi Joniano – Adriatik
IFN	Institucioni Financiar Ndërkombëtar
IHM	Instituti i Hidrometeorologjisë
IPF	Instrumenti Lehtësues i Përgatitjes së Projekteve në Infrastrukturë
KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
KKPT	Këshilli Kombëtar i Planifikimit të Territorit
MKS-64	Shkalla Mercalli 64 – e përdorur për intensitetin sizmik
MTE	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektorike
PMMM	Plani i Menaxhimit dhe Monitorimit të Mjedisit
PVB - BAP	Pani i Veprimit për Biodiversitetin – Biodiversity Action Plan
PZ	Projekti i zbatimit

Shkurtesa	Përshkrimi
RMN	Rezervat i Menaxhuar Natyror
SEMTH	Sistemi Evropian i Menaxhimit të Trafikut Hekurudhor
SEMTH	Sistemi Evropian i Menaxhimit të Trafikut Hekurudhor
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social
ZM	Zonë e Mbrojtur
WBIF	Kuadri i Investimeve në Ballkanin Perëndimor

1 Hyrje

“Projektimi i Detajuar (PD) dhe Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Rehabilitimin e linjës hekurudhore Vorë - Hani i Hotit, Shqipëri” (i quajtur më poshtë “Projekti”), është përgatitur nga konsorciumi SUEZ - IPF6 (i quajtur më poshtë “Konsulentit”).

Projekti është pjesë e zgjerimit indikativ të Rrjetit Kryesor TEN-T në Ballkanin Perëndimor. Kjo është lidhja hekurudhore ndërkombëtare e Shqipërisë me rrjetet hekurudhore rajonale dhe evropiane përmes Korridorit X panevropian.

Promotori është Ministria e Infrastrukturës, Energjisë (MIE), agjencia e zbatimit është Hekurudhat Shqiptare (HSH), dhe IFI drejtues është Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Sipas kërkesave kombëtare, të BE-së dhe BERZH-it, Projekti duhet t'i nënshtrohet një procesi gjithëpërfshirës të VNMS-së.

Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social – PMMS (ky dokument), është pjesë e paketës së studimit të VNMS-së për Projektin.

1.1 Historiku

Linja hekurudhore Vorë - Hani i Hotit, e cila është rreth 120 km e gjatë, është ndërtuar në dy faza: nga Vorë në Laç në fillim të viteve 1960, ndërsa nga Laçi në kufirin shtetëror SH/MZ në vitin 1985.




Figure 1.1_ Skema e rrjetit të linjës hekurudhore shqiptare

Infrastruktura e pistës është në gjendje të keqe për shkak të mungesës së mirëmbajtjes. Shpejtësia maksimale e funksionimit të trenit është 40 km/h. Në disa seksione hekurudhore, ajo është më e ulët

se 20 km/h. Përveç kushteve të trasesë, kufizimet e shpejtësisë së trenave rrjedhin edhe nga kalimet e shpeshta të paautorizuara në nivel. Sistemi i sinjalizimit, i dëmtuar gjatë periudhave të trazirave në 1991 dhe 1997, është pothuajse inekzistent. Shërbimet e transportit të mallrave janë të dobëta me kohë të gjata udhëtimi dhe kërkesë të ulët.

Komunikimi ndërmjet stacioneve realizohet nëpërmjet radios. Nuk ka një sistem të kontrolluar sigurie për lëvizjen e trenave përgjatë linjës, gjë që rrit rrezikun e aksidenteve. Ndërsa gjeometria e shtrirjes është mjaft e mirë.

Së fundmi, tërmeti i datës 26.11.2019 ka ndërprerë funksionimin e kësaj linje hekurudhore për shkak të dëmtimeve të mëdha të shkaktuara në urën e lumit Ishmi, në km 35+100 të linjës.

1.2 Studimi i VNMS-së dhe dokumenti aktual

1.2.1 Procesi i VNMS-së dhe PMMS

Projekti i propozuar ka ndjekur një proces VNMS (kategoria A e BERZH; VNM e plotë sipas rregulloreve shqiptare; VNM gjithëpërfshirëse sipas Direktivës së VNM). VNMS përshkruan komponentët dhe aktivitetet e projektit, receptorët mjedisorë dhe socialë që mund të ndikohen nga Projekti, si dhe ndikimet e mundshme në këta receptorë. VNMS propozon një sërë veprimesh për të shmangur/anuluar/zbutur/kompensuar efektet e mundshme negative dhe, kudo që është e mundur, për të përmirësuar mjedisin ekzistues. Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social përmbledh opsionet më të mira praktike për të adresuar çështjet e identifikuara mjedisore dhe sociale.

Procesi i VNMS-së përfshin hapat e mëposhtëm dhe detyrat kryesore.

Fazat e procesit të VNMS-së dhe detyrat kryesore që lidhen me to

No	Faza e procesit të VNMS-së dhe detyrat kryesore
1	Shqyrtimi (sipas rastit)
2	Përcaktimi i fushëveprimit (sipas rastit)
3	Përgatitja e raportit të VNM

Autoriteti Kompetent (AKM) vendos nëse kërkohet një VNM dhe nëse kërkohet, atëherë cili nivel vlerësimi kërkohet
<ul style="list-style-type: none"> Identifikon çështjet dhe ndikimet kryesore, përmbajtjen dhe shtrirjen e vlerësimit, dhe specifikon informacionin që do të përfshihet në Raportin e VNM-së, Përgatitja e ToR për VNM
Raporti i VNM përfshin 1: <ul style="list-style-type: none"> Informacionin mbi projektin, Informacionin bazë; Ndikimet e mundshme të rëndësishme; Alternativat e propozuara; Masat zbutëse; dhe a

¹ Annex IV of the EIA Directive 2011/92/EU as amended

		<ul style="list-style-type: none"> • Përmbledhje jo-teknike
4	Informim dhe konsultim	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti i VNM konsultohet me publikun dhe palët e interesuara; • VNM përmirësohet aty ku është e nevojshme, në varësi të informacionit të konsultimeve
5	Pëlqimi vendimmarrje për dhe zhvillim	Bazuar në raportin e VNM-së dhe rezultatet e konsultimit, Autoriteti Kompetent (Ministria e Turizmit dhe Mjedisit – MT) vendos nëse projekti shkakton efekte të rëndësishme mjedisore. MTPT përfshin opinionin e saj në vendimin përfundimtar të Pëlqimit Zhvillimor.
6	Informacion mbi Pëlqimin Zhvillimor	Informimi i publikut mbi vendimin e Pëlqimit Zhvillimor.
7	Monitorimi (sipas rastit)	Gjatë ndërtimit dhe funksionimit, zhvilluesi duhet të monitorojë efektet e rëndësishme negative të identifikuar, si dhe masat e propozuara zbutëse

Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social është përfshirë në pikën tre të tabelës së mësipërme. Ai duhet të jetë në përputhje me politikën mjedisore dhe sociale të huadhënësit (BERZH), rregulloret shqiptare dhe Praktikën e Mirë Ndërkombëtare (PMN).

1.2.2 Paketa e kërkuar e studimit të VNMS për Projektin

Konsulenti po përgatit dokumentet e mëposhtme si pjesë e paketës së studimit të VNMS-së për të përmbushur dispozitat ToR, PR-të e Politikës Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it (2019), rregulloret e BE-së dhe ato kombëtare të VNM-së:

- Raporti i fushëveprimit të VNMS-së;
- Raporti i VNMS-së;
- Përmbledhje jo-teknike (PJT);
- Plani i Veprimit Mjedisor dhe Social (PVMS);
- Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit (PAPI);
- Korniza e marrjes së tokës dhe restaurimit të mjeteve të jetesës;
- Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) – ky dokument; dhe a
- Tabela Përmbledhëse e Pajtuëshmërisë së Projektit (kundër KP të BERZH).

1.3 Qëllimi i këtij dokumenti

Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social përbëhet nga një sërë kriteresh menaxhimi dhe masash zbutëse që synojnë zbatimin dhe zhvillimin e suksesshëm të projektit. Zbatimi nga palët e treta kërkon që PMMS të jetë mjaftueshëm i qartë për këto kriterë.

2 Plani i Menaxhimit të Mjedisit

2.1 Qëllimi dhe Objektivat

Bazuar në gjetjet e studimit të VNM-së, Konsulenti, në koordinim me përfituesit, do të shqyrtojë strategjitë/opsionet më të mira praktike për të zgjidhur çështjet e identifikuarat mjedisore dhe sociale. Kjo do të rezultojë në zhvillimin e një Sistemi të Menaxhimit Mjedisor dhe Social, të shprehur qartë dhe lehtësisht të monitorueshëm që do të shërbejë si një dokument kuadër për përgatitjen e një Plani të detajuar të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS) dhe një Plan Veprimi Mjedisor dhe Social (PVMS - ESAP) për çdo fazë të zhvillimit të projektit. Ngjashëm me PMM, PVMS përgatitet si dokument i veçantë. PMM përfshin edhe monitorimin e çështjeve mjedisore dhe sociale. PMM duhet të zhvillohet në përputhje me PR1 të BERZH-it, meqenese projekti financohet nga kjo banke.

PMM synon sa vijon:

- të specifikojë ndikimet e parashikuara mjedisore dhe sociale dhe strategjitë/masat zbutëse përkatëse në çdo fazë të aktiviteteve të projektit;
- siguron zbatimin e saktë të masave zbutëse, duke i monitoruar ato; dhe
- Të identifikojë organet përgjegjëse për aktivitetet e monitorimit.
- PMM përbëhet nga një Plan Menaxhimi Mjedisor dhe Social dhe nga një Plan Monitorimi Mjedisor dhe Social.

2.2 Detyrat/roli dhe përgjegjësitë

Ky nenkapitull parashikon rolet dhe përgjegjësitë nga faza e para-ndërtimit deri në atë të çmontimit.

2.2.1 Zhvilluesi dhe përgjegjës të tjerë të projektit

MIE është përgjegjëse për zbatimin e PMM, përgatitja e të cilit synon të sigurojë zbatimin efektiv të strategjive dhe masave zbutëse, angazhimin e palëve të interesuara dhe kërkesa të tjera mjedisore dhe sociale. Ky zbatim duhet të jetë në përputhje me standardet përkatëse kombëtare, të BE-së, BERZH-it dhe standardeve të tjera ndërkombëtare. Aktivitetet e kontraktorëve do të monitorohen dhe auditohen në përputhje me Programin e Monitorimit, i cili përfshin të gjitha fazat e zhvillimit të Projektit. Rezultatet e monitorimit do të jenë në dispozicion për inspektim nga përfaqësuesit e Kontraktorëve dhe Autoriteteve Shqiptare.

HSH duhet të angazhojë një staf të specializuar për të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të kontrolluar zbatimin e masave, strategjive dhe vendimeve të përshtatshme zbutëse, siç përcaktohet në kontratën e punimeve të ndërtimit dhe lejet përkatëse. Ky kontroll përfshin edhe koordinimin me institucione të tjera shtetërore, si Drejtoria Rajonale për Mbrojtjen e Mjedisit, AKM-ja, Agjencia Rajonale e Zonave të Mbrojtura dhe AKMSH-ja dhe në kuadër të MASH-it, ASA-së në Ministrinë e Kulturës, ARM-ve dhe pushtetit vendor të bashkive të prekura nga aktivitetet e projektit etj.

HSH duhet të zhvillojë mekanizmat e nevojshëm për trajtimin e të gjitha çështjeve të mundshme mjedisore dhe sociale gjatë të gjitha fazave të zhvillimit të projektit. Si zhvillues i projektit, MIE duhet të shërbejë edhe si pikë kontakti për konsultime dhe reagime me të gjithë aktorët e prekur, përfshirë pronarët e tokave dhe publikun.

2.2.2 Kontraktuesi

Kontraktuesi përfaqëson kompaninë e ndërtimit/operimit/çmontimit. Ai do të përgatisë një plan të detajuar në lidhje me strategjitë dhe masat zbutëse që lidhen me të gjitha aktivitetet e projektit, nga parandërtimi tek ndërtimi, funksionimi dhe më tej, te punimet e çmontimit dhe rehabilitimit të mejdist, përfshirë aspektet e pronësisë së tokës, dëmtimet e përkohshme ndaj pronës private, bashkiake, apo pronësinë shtetërore, si dhe çështjet e informimit dhe konsultimit publik. Kontraktori do të sigurojë MIE-s planet dhe procedurat e duhura për miratim përpara fazës së ndërtimit.

Këto plane dhe procedura duhet të zhvillohen në përputhje me aspektet e mëposhtme:

- Legjislacioni, procedurat dhe standardet përkatëse;
- Kontrollat mjedisore dhe socio-ekonomike dhe strategjitë e masat zbutëse të përshkruara në PMS; dhe
- Kodet e sjelljes të kërkuara nga zhvilluesi i projektit (MIE).

Kontraktori duhet të përmbushë një sërë detyrash, duke përfshirë:

- Ndërmarrja e inspektimeve të rregullta mjedisore dhe socio-ekonomike dhe raportimi direkt të zhvilluesi i projektit (MIE);
- Demonstrimi se si kërkesat e PMMS do të sigurohen gjatë zhvillimit të Projektit;
- Demonstrimi i përkushtimit ndaj PMMS në të gjitha nivelet në strukturën e menaxhimit të kontraktorëve duke përfshirë nënkontraktorët; dhe
- Përgatitja e një PMMS të Kontraktorit për detyrat dhe procedurat që duhen ndjekur.

PMM për detyrat dhe procedurat e kontraktorit duhet të përfshijë kryesisht:

- Procedurat mjedisore;
- Organizimi dhe personi përgjegjës për çdo çështje mjedisore dhe menaxheriale, duke përfshirë menaxherin e EHS, mbikëqyrësit e EHS, oficerët e CHS dhe OHS, etj., si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e tyre;
- Inspektimi i vendit dhe çështjet e shëndetit dhe sigurisë;
- Të drejtat e punëtorëve dhe kushtet e punës;
- Procedurat e auditimit; dhe
- Procedurat e raportimit.

Përgjegjësitë në fazën e çmontimit janë të ngjashme me ato të parandërtimit dhe të ndërtimit.

HSH dhe kompania/të e ndërtimit do të jenë përgjegjëse për PMM gjatë fazave të para-ndërtimit dhe ndërtimit.

Funksionimi dhe mirëmbajtja e hekurudhës do të jetë nën përgjegjësinë e Hekurudhës Shqiptare – pronar dhe operator. Ligji i propozuar i datës 09.12.2019 parashikon riorganizimin e Hekurudhës Shqiptare në katër shoqëri shtetërore që do të kenë këto përgjegjësi:

- Infrastruktura;
- Transporti i pasagjerëve;
- Transporti i mallrave; dhe
- Mirëmbajtja e mjeteve

Kompania e ngarkuar me infrastrukturën do të jetë përgjegjëse për mirëmbajtjen e linjës hekurudhore, përfshirë trasenë, sistemin e kullimit, urat, sinjalistikën dhe telekomunikacionin, rrethimin, etj.). Ndërsa kompania përgjegjëse për mjetet lëvizëse do të merret me mirëmbajtjen e lokomotivave dhe vagonëve.

2.2.3 Rishikimi dhe amendimi/perditesimi i PMM

MIE do të rishikojë rregullisht PMM-ne, për të reflektuar çdo ndryshim në zbatimin dhe organizimin e projektit. Pas çdo ndryshimi, plani i ndryshuar do të komunikohet të gjitha palëve të interesuara

2.3 Plani i menaxhimit të mjedisit

2.3.1 Permbajtja e planit të menaxhimit mjedisor dhe social

Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social përfshin një varg kriteresh menaxhimi dhe masash zbutëse, të cilat duhet të sigurojnë zbatimin e suksesshëm të projektit. Ato përfshijnë edhe masat institucionale që duhen marrë gjatë zbatimit të projektit, me qëllim eliminimin e ndikimeve negative, kompensimin, ose zbutjen e tyre në nivele të pranueshme.

PMM duhet të sigurojë zbatimin e të gjitha fazave të projektit në përputhje me rregulloret mjedisore dhe sociale shqiptare në fuqi, dhe të BERZH dhe/ose kërkesat e tjera Mjedisore dhe Sociale të IFI-së, si dhe në përputhje me gjetjet e konsultimeve me palët e interesuara.

Zbutja dhe Menaxhimi i Ndikimeve, përfshin kryesisht:

- Parashikimi i burimeve të ndikimeve të mundshme mjedisore dhe sociale;
- Përshkrimi i ndikimeve të mundshme për secilën nga fazat e projektit (projektimi, parandërtimi dhe ndërtimi, funksionimi dhe çmontimi, mbyllja dhe rehabilitimi);
- Vlerësimi i probabilitetit, rëndësisë dhe shtrirjes së ndikimeve të mundshme;
- Sugjerimi i strategjive dhe masave zbutëse përkatëse;
- Përcaktimi i përgjegjësive në të gjitha fazave të zhvillimit të projektit;
- Rregullimi institucional; dhe
- Marrja në konsideratë e mundësisë për të përmirësuar aspektet mjedisore dhe sociale brenda zonës së projektit.

Masat zbutëse të propozuara duhet të përfshihen në planin e veprimit mjedisor dhe social (PVM), i cili është pjesë e paketës së studimit të VNMS-së.

Strategjitë dhe masat zbutëse kanë të bëjnë kryesisht në sa vijon:

- Zbatimi, fillimisht, i parimit të shmangies;
- Të zvogëlojë në maksimum ndikimet negative të pashmangshme gjatë procesit të përzgjedhjes së rrugës, dhe më pas gjatë fazës së projektimit; dhe
- Përcaktimi i strategjive dhe veprimeve zbutëse në përputhje me legjislacionin dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare;

Aty ku ndikimet nuk mund të shmangen, ato duhet të reduktohen në minimumin e nevojshëm për zbatimin e sigurt të projektit. Aty ku ndikimet e rëndësishme nuk mund të shmangen, të merren

parasysh masa zbutëse që synojnë të kompensojnë ndikimet përmes kompensimit. Gjithashtu do të merren parasysh dhe identifikohen mundësitë për të rritur ndikimet positive të projektit.

2.3.2 Strategjia e masave zbutëse

Table 2.1 dhe 1.3 në fund të këtij dokumenti, japin masat e sugjerura zbutëse gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit të projektit.

2.3.3 Plane specifike menaxhimi

Përgatitja e PMM bazohet në një sërë planesh menaxhimi për tema specifike. Secila prej tyre zhvillohet për të trajtuar në holles çështjet kyçe të ndikimeve dhe rreziqeve të mundshme në mjedis. Këto plane konsiderohen si dokumente "të drejtpërdrejta", sepse ato duhet të përditësohen rregullisht me rritjen e cilësisë dhe sasisë së informacionit për zonën e projektit, si dhe me ecurinë e zhvillimit të projektit.

Plane ose nënplane shtesë mund të shtohen për tu marrë me vlerësimin e çdo receptori të ri mjedisor ose ndikimi të identifikuar rishtazi gjatë aktiviteteve të projektit.

Në vijim vijon një listë e planeve specifike të menaxhimit të parashikuara për projektin e propozuar, si dhe një përmbledhje e secilit prej tyre. Lista bazohet në gjetjet e Raportit të VNM-së, si dhe në Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it².

Table 2.1_Lista e nën-planeve specifike të propozuara nga Konsulenti gjatë përgatitjes së VNM-së

Nr.	Nën-plani specifik	Shënim/vërejtje
1	Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit / Stakeholders Engagement Plan	Perditesohet gjatë gjithë fazave të zhvillimit të Projektit
2	Korniza e shpronësimeve dhe restaurimit të mjeteve të jetesës/ Land Acquisition and Livelihood Restoration Framework	Përgatitur gjatë Projektit të detajuar dhe VNM
3	Plani i Zhvendosjes	Te përgatitet nga HSH para fillimit të Ndertimit. Te marre parasysh standartet vendase dhe të BERZH
4	Plani i Investimeve Sociale dhe Mjedisore	Është marrë tashmë në konsideratë gjatë hartimit e Projektit. Prandaj nuk ka nevojë për këtë plan.
5	Plani i kontrollit të erozionit dhe sedimentimit	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndertimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit
6	Plani i menaxhimit të sipërfaqes së tokës	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndertimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit
7	Plani i Menaxhimit të Ujit	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndertimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit
8	Plani i kalimit të rrjedhave ujore	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndertimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit

² <https://www.ebrd.com/news/publications/policies/environmental-and-social-policy-esp.html>

Nr.	Nën-plani specifik	Shënim/vërejtje
9.1	Plani i Veprimit për Biodiversitetin	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndërtimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit
9.2	Strategjia e kompensimit/zevendesimit te biodiversitetit / Biodiversity Offset Strategy	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndërtimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit
10	Plani i Menaxhimit të Infrastrukturës dhe Shërbimeve	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndërtimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit
11	Plani i Menaxhimit të Trafikut	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndërtimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit
12	Plani i Menaxhimit të Peizazhit	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndërtimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit
13	Plani i Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore dhe Procedura e Gjetjeve të Rastësishme	Duhet të përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndërtimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit, rishikohet dhe zbatohet përpara se të kryhet ndonjë aktivitet ndërtimor.
14	Plani i Menaxhimit të Materialeve të Ndërtimit	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndërtimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit
15	Plani i Menaxhimit të Mbetjeve	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndërtimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit
16	Plani i Parandalimit dhe Reagimit ndaj Ndotjes	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndërtimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit
17	Plani i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Komunitet	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndërtimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit
18	Plani i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndërtimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit
19	Plani i menaxhimit të punës dhe kushteve të punës	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndërtimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit
20	Plani i veprimit në rast emergjence	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndërtimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit
21	Plani i Menaxhimit të i Zinxhirit të Furnitoreve	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së parandërtimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit
22	Plani i Menaxhimit të Sigurisë	Te përgatitet nga Kontraktuesi para fazes së ndërtimit; Te jete i detyrueshem ne dokumentat e tenderimit

Projekti teknik (shih paragrafin 2.3.3.3 më poshtë) i cili ka marrë tashmë parasysh Planin e Investimeve Sociale dhe Mjedisore (shih pikën nr. 4 në tabelën e mësipërme).

Më poshtë vijon një përshkrim tregues i secilit prej nënplaneve të përfshira në tabelën e mësipërme.

2.3.3.1 Plani i përfshirjes/pjesëmarrjes së aktoreve, vendimarrësve (SEP)

ToR, të miratuara nga BERZH, kërkojnë përgatitjen e Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit (SEP), si një dokument i pavarur. SEP pasqyron qasjen e komunikimit dhe konsultimit me palët e interesuara, të identifikuar gjatë gjithë fazave të zhvillimit të projektit. Rregulloret shqiptare kërkojnë që

konsultimi publik të jetë i dokumentuar, por këto kërkesa janë më pak të rrepta se sa ato të BERZH-it. Kështu, SEP u përgatit në përputhje me kërkesat e BERZH-it.

PR 10 e BERZH-it “Zbulimi i informacionit dhe Angazhimi i Palëve të Interesit” flet edhe për karakteristikat dhe objektivat e SEP. Sipas PR 10, angazhimi i palëve të interesuara përfshin elementët e mëposhtëm:

- Identifikimi dhe analiza e palëve të interesuara;
- planifikimi i angazhimit të palëve të interesuara;
- zbulimi i informacionit;
- konsultim kuptimplotë, zbatimi i mekanizmit të ankesave; dhe
- raportim i vazhdueshëm tek aktorët përkatës.

Mekanizmi i ankesave bazohet në shënimin udhëzues të BERZH-it mbi “Menaxhimin e Ankesave”.

Korniza e shpronësimeve dhe restaurimit të mjeteve të jetesës ToR, standartet kombëtare dhe të BE-së, dhe standartet e BERZH, kërkojnë përgatitjen e një PRJ për të trajtuar çështjet e shpronësimeve. PRJ përgatitet si dokumente të pavarura. PRJ u përgatitet gjatë fazës së fushëveprimit (scoping report). PRJ përditësohet gjatë Projektimit Paraprak dhe Projektimit të Detajuar. Përditësimi përfshin sipërfaqen e tokës që kërkohet për rrugët e shërbimit dhe stacionin e ri Lezhe 2, si dhe çdo kërkesë tjetër për tokë, në kuadër të përmbushjes së objektivave të Projektit.

PRJ jep parimet e përgjithshme, procedurat dhe kuadrin e të drejtave në lidhje me ndikimet e mundshme të shpronësimeve, në përputhje me ligjet kombëtare dhe kërkesat e BERZH-it.

PRJ shërben si një udhëzues shtesë për të kapërcyer çdo boshllëk midis legjislacionit kombëtar dhe kërkesave të BERZH-it në lidhje me shpronësimet dhe restaurimin e aseteve të demtuara.

Përgatitja e PRJ bazohet si në Ligjin Shqiptar mbi Shpronësimin, si dhe në PR 5 të BERZH-it

Ligji kryesor që rregullon shpronësimin dhe drejton procesin e marrjes së tokës për Projektin, është Ligji 8561/1999 për “Shpronësimin dhe Marrjen e Përkohshme të Pronës Private për Interes Publik” (Ligji i Shpronësimin), i cili plotësohet nga disa VKM, udhëzime, dhe rregullore.

PR 5 e BERZH trajton çështjet e blerjes së tokës, kufizimit të përdorimit të saj, dhe shpernguljes (resettlement).

2.3.3.2 Plani i Zhvendosjes (PZH)

Plani i Zhvendosjes (PZH) shërben si bazë për zhvillimin e një LARP të detajuar, i cili zhvillohet pasi të njihet natyra dhe madhësia e saktë e nevojave për tokë, ose kufizimet në përdorimin e tokës. LARP jep më shumë detaje mbi Personat e Prekur nga Projekti (PAP), kriteret e pranueshmërisë dhe procedurat që do të zbatohen për Projektin në përputhje me PZHJ dhe në përputhje me ligjet kombëtare (kudo që është e zbatueshme) dhe PR5 të BERZH-it.

Qëllimi i PZH është të trajtojë zhvendosjen e mundshme ekonomike (humbjen e aseteve ose qasjen në asete, që çon në humbje të të ardhurave ose mjeteve të jetesës) dhe zhvendosjen fizike (zhvendosje ose humbje strehimi) të palëve të interesuara nga shpronësimet në dobi të projektit. LARP përcakton të drejtat e personave ose komuniteteve të prekura dhe siguron që kompensimi të jete transparent, i qëndrueshem, dhe i barabartë, në përputhje me kërkesat e BERZH-it.

Objektivat kryesore të PZH përfshijnë:

- Sigurimi i kompensimit korrekt për humbjen e aseteve;
- Të sigurohet që aktivitetet e zhvendosjes të zbatohen me njohjen të informacionit të duhur, konsultimin dhe pjesëmarrjen e komuniteteve të prekura;
- Përmirësimi ose, së paku, rivendosja e aseteve dhe standardeve të jetesës së personave të zhvendosur në nivelet para projektit, për të lehtësuar përmirësimet e qëndrueshme të statusit socio-ekonomik; dhe
- Vëmendje të veçantë ndaj nevojave të grupeve të cenueshem

Një qasje ndaj LARP, përfshin:

- Përshkrim gjithëpërfshirës i projektit, përfshirë tokën/servitutin që do të merret;
- Kuadri ligjor dhe procedurat ligjore të marrjes së tokës private/servitut;
- Masat për të shmangur dhe minimizuar zhvendosjet fizike dhe ekonomike;
- Vlerësimi gjithëpërfshirës i ndikimeve të zhvendosjes ekonomike;
- Matrica e të drejtave që identifikon llojin e ndikimit nga blerja e tokës dhe servitutit dhe ofron udhëzime të detajuara për kompensimin e palëve të interesuara;
- Vlerësimi i detajuar i kostos për artikujt e identifikuar, bazuar në parimin e kostos së zëvendësimit;
- Përgjegjësitë organizative për procesin e shpronësimit;
- Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit, i cili përshkruan parimin e konsultimeve gjatë procesit të shpronësimit.
- Konsultim publike, i cili përshkruan procedurat dhe afatin kohor për të shpalosur draftin dhe planin përfundimtar, si dhe raportet e monitorimit në nivel lokal;
- Mekanizmi i ankesave për trajtimin e ankesave, duke përfshirë edhe rekursin gjyqësor;
- Vlerësimi i cilësisë, rezultateve dhe kënaqësisë së palëve të interesuara;
- Monitorimi i ecurisë së pjesëmarrjes, për të siguruar informacionin objektiv

2.3.3.3 Plani i investimeve mjedisore e sociale

Plani i Investimeve mjedisore dhe Sociale synon të përmirësojë kushtet e jetës së komuniteteve të prekura drejtpërdrejt ose tërthorazi nga zhvillimi i projektit.

Ky plan përfshin aspektet e mëposhtme:

- Konteksti lokal: Gjetjet kryesore nga procesi i VNM-së, përfshirë vlerësimin e proceseve lokale të komunikimit dhe vendimmarrjes, sfidat dhe mundësitë kryesore të paraqitura nga konteksti lokal.
- Angazhimi dhe planifikimi: Procesi i angazhimit të palëve të interesuara duhet të beje një renditje paraprake të perparësive të popullatës së prekur, në lidhje me nevojat dhe kërkesat për investime. Këto investime shërbejnë edhe si kompensim për ndikimet lokale.
- Të hartohet një plan specifik i zbatimit të këtij nen-plani. Ky plan duhet të përfshijë arsyetimin për përzgjedhjen, partnerët e mundshëm, rolet, përgjegjësitë, dhe planin e zbatimit.

Konsulenti thekson se gjetjet kryesore të procesit të studimit të VNM-së, në lidhje me planin e investimeve sociale dhe mjedisore, janë tashmë të integruara në hartimin e Projektit, përmes sa vijon:

- Nënkalime të reja shtesë për të plotësuar nevojat e komuniteteve lokale (p.sh. nënkalmi i ri në fshatin Spathar – Bashkia Vau Dejës);
- Tombino të reja shtesë për të shmangur përmbytjen e tokës bujqësore (p.sh. tre tombino të reja në segmentin nga km 32 deri në km 35);
- Rritja e diametrit të tombinove të reja, në mënyrë që ato të shërbejnë edhe si nënkalmime bujqësore (p.sh. 3x2 m në vend të 2x2 m);
- Përmirësimi i kanaleve ekzistuese kulluese, në të dy anët e linjës hekurudhore, për të shmangur përmbytjen (ose të paktën zvogëlimin e kohëzgjatjes) të tokës bujqësore të ulët gjatë reshjeve intensive (p.sh. km 32 deri në km 35; km 70 deri në km 74; km 101 deri në 102);
- Tumbona të reja shtesë për të shërbyer si kalim i faunës së egër brenda territorit të Bashkisë Malësia e Madhe ,ku linja hekurudhore kalon Rezervatin Natyror të Menaxhuar të Liqenit të Shkodrës;
- Rehabilitimi i punimeve mbrojtëse nga erozioni i lumenjve dhe përrenjve. P.sh. rehabilitimi i punimeve mbrojtëse në anën e djathtë të shtratit të lumit Kir, nga km 103 deri në km 107;
- Ndërtimi i mureve ndërmjet linjës hekurudhore dhe shtëpive/ndërtesave private që ndodhen shumë afër shinave. Këto objekte infrastrukturore janë ndërtuar pa respektuar as planet urbanistike vendore dhe as Kodin Hekurudhor. Muret e projektuara do të mbrojnë popullatën nga aksidentet hekurudhore dhe nga zhurmat dhe dridhjet e trenave;
- Ndërtimi i barrierave kunder zhurmës, në 14 segmente të shkurtra të hekurudhes;
- Ndërtimi i kalesave të sigurta në nivel, në funksion të nevojave të komuniteteve lokale;
- Projektimi i rrugëve të shërbimit në funksion të ndryshimeve më të fundit të zhvillimit urban dhe të sugjerimeve të bashkive të prekura;
- Përshtatja e projektit të stacioneve dhe kalesave në nivel me nevojat e personave me aftësi të kufizuara, fëmijëve dhe të moshuarve; etj.

Nga sa më sipër, rezulton se nuk ka nevojë për ndonjë Plan Investimi Social dhe Mjedisor shtesë.

2.3.3.4 Plani i kontrollit të erozionit dhe sedimentimit

Plani i kontrollit të erozionit dhe sedimentimit është si një manual udhëzues për minimizimin e erozionit të dherave dhe transportimin e sedimenteve gjatë aktiviteteve të projektit. Ai synon të zbatohet standarde për mbrojtjen e zonave të ndjeshme ndaj mjedisit.

Plani ofron informacion të përgjithshëm mbi proceset e ndërtimit dhe përshkruan masat specifike që duhen marrë gjatë dhe pas ndërtimit, për të minimizuar ndikimet në mjedis në vendet e projektit.

Plani synon të ruajë integritetin e zonave të ndjeshme mjedisore duke zbatuar objektivat e mëposhtme:

- Minimizim i shtrirjes dhe kohëzgjatjes së ndikimit;
- Mbrojtje e tokës së ekspozuar, duke devijuar rrjedhën e ujrave në zona të qendrueshme;
- Të trajtojë siç duhet menaxhimin e sedimenteve;
- Instalim i masave të përkohshme dhe të përhershme për kontrollin e erozionit; dhe
- Përgatitja e një programi efektiv inspektimi dhe mirëmbajtjeje.

Përsa i përket erozionit, segmentet më të ndjeshme janë kalimet e rrjedhave ujore dhe segmenti nga km 139 deri në km 140 ku linja hekurudhore kalon (50 deri në 70 m) afër liqenit të Shkodrës. Edhe pse një autostradë shtrihet midis shinës hekurudhore dhe liqenit, projektit përfshin kanale të përmirësuara kullimi në të dy anët e linjës hekurudhore, për të shmangur transportin e sedimenteve drejt Liqenit të Shkodrës.

2.3.3.5 Plani i menaxhimit të mbuleses të tokës (topsoil)

Plani i Menaxhimit të mbuleses së tokës është një manual udhëzues për minimizimin e humbjes së tokës prodhuese, dëmtimeve në structure, apo ndotjen e saj.

Plani jep informacion të përgjithshëm mbi proceset e ndërtimit dhe një hartë të cilësisë së tokës, brenda gjurmës së të Projektit. Ai sugjeron masa specifike, para procesit të ndërtimit, për të minimizuar ndikimet në shtresën vegetale të tokës.

Plani duhet të përfshijë:

- hartat që tregojnë llojet e tokës në sipërfaqe dhe thellesi, si dhe zonat ku shtresa sipërfaqësore duhet hequr;
- hartat e zonave të tokës që duhet të mbrohen nga aktivitetet e ndërtimit;
- rrugët hyrëse;
- metodat për heqjen e grumbullimit të mbuleses së tokës dhe rruget për përmirësimin e cilësisë së saj;
- vendndodhjen, përmbytjen dhe vëllimin e çdo rezerve dhe/toke vegetale;
- Konsultimet me pushtetin vendor, dhe institucionet e tjera të ndërlidhura, për ripërdorimin e mbuleses së tokës;
- personat/institucionet përgjegjëse për mbikëqyrjen e menaxhimit të tokës;

Në lidhje me projektin e propozuar, sipërfaqja ku mbulesa e tokës do të hiqet përgjithmonë përfshin:

- Rreth 1.4 ha tokë bujqësore për stacionin e ri të mallrave Lezhe 2;
- Përafërsisht, 4.0 ha tokë private për rrugët e reja të shërbimit dhe 2.1 ha për rrugët e reja të lidhjes.

Ripërdorimi i mbuleses së tokës do të vendoset nga konsultimi ndërmjet kontraktorit dhe pushtetit vendor.

Sipërfaqja e tokës, struktura e së cilës mund të dëmtohet nga aktivitetet e Projektit ndodhet kryesisht brenda brezit të punimeve të ndërtimit të linjës hekurudhore.

2.3.3.6 Plani i menaxhimit të ujit

Përgatitja e Planit të Menaxhimit të Ujit synon:

- Identifikimi i aktiviteteve që kërkojnë konsum uji dhe vlerësimi i sasisë së ujit të përdorur nga aktivitetet e projektit;
- Procedura e raportimit për regjistrimin e vëllimeve të ujit të shfrytëzuar;
- Sigurimi i masave të duhura për të minimizuar përdorimin e ujit;
- Identifikimi i autoriteteve kombëtare dhe lokale dhe aktorëve të tjerë përkatës, dhe i procedurave të duhura për të komunikuar me ta. Burimet ujore do të përdoren pasi të kete marrëveshje me autoritetet përkatëse vendore.
- Regjistrimin e të gjitha komunikimeve me Autoritetet e Ujit;
- Menaxhimi i ndërprerjeve të sistemeve të ujitjes;
- Sigurimi i procedurave për komunikimet e brendshme dhe të jashtme gjatë emergjencave; dhe
- Sigurimi i trajnimit të punonjësve, për të minimizuar përdorimin e ujit dhe për të reaguar në rast ndotjeje aksidentale të ujit.

Në lidhje me projektin e propozuar, nevoja më e madhe për shfrytëzimin e ujit do të jetë gjatë ndërtimit të urave të reja përgjatë lumenjve dhe perrenjve.

2.3.3.7 Plani i kalimit të rrjedhave ujore

Ne linjën hekurudhore, nga Vore në Hani Hotit, kalimet e rrjedhave ujore përfshijnë:

- Ndërtimi dhe/ose rehabilitimi i urave dhe kanaleve;
- Ndërtimi dhe/ose rehabilitimi i punimeve mbrojtëse nga erozioni i lumenjve dhe perrenjve; dhe
- Segmenti nga km 139 deri në km 140, ku linja hekurudhore kalon pranë liqenit të Shkodrës.

Plani i kalimit të rrjedhave ujore përshkruan qasjet dhe teknikat e planifikuara për të ekzekutuar kalimet e rrjedhave ujore, të parashikojë ndikimet mjedisore, dhe të parashikojë monitorimin e duhur.

Një plan tipik i kalimit të rrjedhave ujore përfshin komponentët e mëposhtëm:

- Objektivat dhe Qasja:
 - Identifikimi i receptorëve kyç mjedisorë dhe ekologjikë të prekur nga ndërtimi hekurudhes mbi rrjedhat ujore;
 - Një pasqyrë të shkurtër të qasjes dhe teknikave të ndërtimit mbi lumenj/perrenj; dhe
 - Analiza e ndikimit të mundshëm në këta receptorë kryesorë dhe masat e propozuara zbutëse.

Qasja dhe teknikat e kalimit, si dhe ndikimet dhe zbutja e tyre, duhet të bazohen në të dhënat dhe informacionet specifike për çdo vendkalim. Qasja e monitorimit do të bazohet gjithashtu në veçoritë specifike të vendit të ndërtimit.

- Përshkrimi i punimeve dhe plani i aktiviteteve të projektit

Përshkrimi i aktiviteteve të kalimit të rrjedhës ujore dhe orarin e parashikuar. Kjo është gjithashtu e nevojshme për të shmangur periudhat e reshjeve, kur lumenjtë dhe përrrenjtë vërshojnë.

- Teknikat e ndërtimit dhe kampet e punës për urat kryesore

Ky paragraf do të përshkruajë specifikimet e aspekteve teknike dhe logjistike, fuqinë punëtore, pajisjet dhe materialet e ndërtimit që do të përdoren, etj.

- Ndikimet e mundshme
 - Përshkrimi i kriterëve të ndjeshmërisë për receptorët mjedisorë lokalë;
 - Përshkrimi i ndikimeve të mundshme në receptorët biofizikë dhe socio-ekonomikë, përfshirë karakteristikat hidromorfologjike të rrjedhës ujore.

Strategjia dhe masat e sugjeruara zbutëse

Sigurimi i të gjitha referencave të kryqëzuara për pjesët përkatëse të VNM-së dhe PMM-së, të cilat përfshijnë standardet ndërkombëtare dhe udhëzimet e praktikave më të mira për masat zbutëse gjatë kalimeve të tilla.

- Rikthimi në gjendjen e mëparshme
 - Specifikimi i kërkesave, përfshirë pajisjet dhe materialet që do të përdoren; dhe
 - Specifikimi i aspekteve teknike dhe logjistike.
- Monitorimi
 - Përshkrimi i objektivave, fushëveprimit dhe metodave/raportimit të monitorimit; dhe
 - Specifikimi i kërkesave të monitorimit. Monitorimi do të përgatitet dhe kryhet sipas veçorive biofizike lokale dhe objektivave të kthimit të mjedisit në gjendjen e mëparshme.
- Përgjegjësitë, kërkesat ligjore
 - Kërkesat legjislative për miratimin kombëtar dhe lokal; dhe
 - Vështrim i përgjithshëm i konfigurimit të kontraktorit/nëkontraktorit.
- Aktorë e përfshirë
 - Përcaktimi i mënyrave dhe pikave të nevojshme të kontaktit me autoritetet përkatëse; dhe
 - Të mundësojë palët e interesuara të monitorojnë aktivitetet e kalimit të rrjedhave ujore.

2.3.3.8 Plani i Veprimtë për Larmine Biologjike (biodiversitetin)

E vetmja zonë e mbrojtur pranë ose që përshkohet nga linja hekurudhore është NMR e Liqenit të Shkodrës – Parku Natyror (Kategoria IV e IUCN).

Nga km 113+700 deri në km 135+700, hekurudha kalon zonën e përdorimit të qëndrueshëm (kategoria VI e statusit të mbrojtjes së IUCN) të NMR të Liqenit të Shkodrës - Parku Natyror. Duhet theksuar se zona qendrore dhe zona e menaxhimit të habitatit/specieve që i përkasin përkatësisht kategorive II dhe III të IUCN, ndodhen shumë larg linjës hekurudhore. Karakteristikat e zonës së përdorimit të qëndrueshëm që përshkohet nga linja hekurudhore janë si më poshtë:

- Km 113+700 deri në km 119+300: hekurudha kalon përmes tokave të punueshme dhe vendbanimeve rurale pranë autostradës, e cila shërben si kufi tokësor i RMN te liqenit të Shkodres;
- Km 119+300 deri në km 132+600: hekurudha kalon përmes tokës së punueshme dhe vendbanimeve rurale; dhe
- Km 132+600 deri në km 135+700: hekurudha kalon nëpër një zonë me shkurre që tashmë është e defragmentuar nga sa vijon:
 - Linja hekurudhore, e cila shkon në drejtim të veriut;
 - Tre rrugë lokale që shkojnë përgjithësisht pingul me linjën hekurudhore. Secili prej tyre kalon një vendkalim të autorizuar në nivel;
 - Disa parcela toke arë dhe kullota
- Hekurudha përshkon tre përrenj (Rrjoll, Banushi dhe Perroi Thate), shtretërit e të cilëve kanë ujë vetëm gjatë reshjeve, të mbuluara me zhavorr dhe për rrjedhojë pa bimësi.

Bazuar në sa më sipër, Plani i Veprimit për Biodiversitetin, do të kushtojë vëmendje të veçantë kalimit të zonës me shkurre nga km 132+600 në km 135+700.

Plani i Veprimit për Biodiversitetin (BAP) synon integrimin e ruajtjes së biodiversitetit brenda sistemit të menaxhimit mjedisor. Ai parashikon masat e nevojshme për të siguruar ruajtjen e biodiversitetit dhe mirëmbajtjen e funksioneve të ekosistemeve të prekura.

BAP synon të mbrojë mjedisin ekzistues biologjik dhe të rivendosë biodiversitetin lokal të prekur, pasi të kryhen aktivitetet e ndërtimit. Ai identifikon dhe përshkruan mënyrat, veprimet dhe mjetet e nevojshme për zbatimin e tij. Përveç kësaj, BAP përcakton kohën, burimet dhe përgjegjësinë për të përmbushur këto nevoja.

Elementet kryesore të një plani veprimi për biodiversitetin përfshijnë:

- Auditimi, për të rishikuar gjendjen e biodiversitetit lokal;
- Objektivat, për të fokusuar veprimet në objektiva të sakta;
- Prioritetet, për të optimizuar burimet në dispozicion;
- Planet e veprimit për speciet dhe habitatet, për të renditur dhe përshkruar të gjitha veprimet që do të zbatohen për komponentët natyrorë;
- Marrëveshjet e monitorimit dhe rishikimit, për të ruajtur gjurmët se si janë përmbushur objektivat, dhe për të përshtatur veprimet me kushtet në ndryshim.

Si pjesë e këtij ushtrimi, do të ndërmerret një proces konsultimi me aktorët kryesorë, duke përfshirë Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTM), ARM-të, AKZM-ne, ARZM Lezhë dhe Shkodër, si dhe përfaqësues të komuniteteve vendore. Pjesëmarrja e banorëve vendas është burim kyç për vlerësimin e ndikimeve indirekte nga prerja e pyjeve, gjuetia dhe peshkimi.

Në lidhje me projektin e propozuar, PVB duhet të përqendrohet në kalimin e pyjeve dhe shkurreve të degraduara (km 132+600 deri në km 135+700; dhe km 135+700 deri në km 137+700).

Duke u nderthurur me Planin e Kalimit të Rrjedhave Ujore, Planin e Kontrollit të Erozionit dhe Sedimentimit, Planin e Menaxhimit të agregateve, Planin e Menaxhimit të Mbetjeve, dhe Planin e Menaxhimit të Ujrave te ndotura, dhe Planin e manaximit te Parandalimit të Derdhjeve.

2.3.3.9 Plani i menaxhimit të infrastructures dhe shërbimeve

Plani i Menaxhimit të Infrastrukturës dhe Shërbimeve synon të minimizojë shqetësimet në shërbimet e infrastrukturës dhe të përmirësojë situatën ekzistuese.

Objektivat e Planit të Infrastrukturës dhe Shërbimeve përfshijnë:

- Minimizimi i dëmtimit të infrastrukturës nga aktivitetet e ndërtimit;
- Të sigurohet që humbjet e infrastrukturës ose shërbimeve të jenë të përkohshme dhe të parëndësishme;
- Sigurimi i disponueshmërisë së shërbimeve të infrastrukturës për komunitetet lokale nëpërmjet mënyrave alternative të përkohshme; dhe
- Të sigurohet që infrastrukurat e reja do të përmirësojnë kushtet e jetës në zonën e studimit.

Plani i Infrastrukturës dhe Shërbimeve Komunale përfshin:

- Njoftimi dhe angazhimi i palëve të interesuara: Qasja dhe aktivitetet për të njoftuar dhe konsultuar me palët e interesuara për zhvillimin e infrastrukturës;
- Vlerësimi i Shërbimeve Publike: Detajimi i qëllimit dhe gjetjet e vlerësimit të shërbimeve publike;
- Mbyllja dhe ndërtimi i rrugëve: Kërkesat për mbylljen e rrugëve për aktivitetin e ndërtimit/përmirësimit dhe masat për të minimizuar ndërprerjen e trafikut;
- Plani i Përmirësimit të Infrastrukturës: Qasja ndaj përzgjedhjes së aktiviteteve për përmirësimin e infrastrukturës; dhe
- Monitorimi: Qasje për monitorimin e përmirësimeve të infrastrukturës dhe çdo ndërprerje të shërbimeve, ankesat e komunitetit dhe ecurinë/menyrën e reagimit.

Në lidhje me Projektin e Rehabilitimit të Hekurudhës Vore-Hani Hotit, shërbimet e infrastrukturës që mund të preken nga aktivitetet e ndërtimit janë linjat elektrike ajrore dhe nëntokësore, linjat e telekomunikacionit, tubacionet e furnizimit me ujë, si dhe gazsjellësi i planifikuar Jonian-Adriatik. Ndikimet e mundshme të Projektit në infrastrukurën rrugore janë përmendur në Planin e Menaxhimit të Trafikut (shih më poshtë).

2.3.3.10 Plani i menaxhimit të trafikut

Plani i Menaxhimit të Trafikut (TMP) synon të shmangë/minimizojë ndërprerjen dhe shqetësimin e trafikut, përfshirë vonesën e përdoruesve të rrugëve, si dhe të garantojë sigurinë e komuniteteve lokale, fuqisë punëtore dhe drejtuesve të makinerive të punës dhe transportit.

Objektivat e Planit të Menaxhimit të Trafikut përfshijnë:

- Hyrja në zonen e projektit;
- Drejtimi i trafikut gjatë ndërtimit;
- Parandalimi i vonesës së përdoruesve të rrugës;
- Kontroll dhe menaxhim i përkohshëm i trafikut;
- Reduktimi i probabilitetit të incidenteve dhe aksidenteve në trafik dhe përmirësimi i sigurisë së komuniteteve lokale, fuqisë punëtore dhe përdoruesve të rrugës;

- Parandalimi dhe korrigjimi i perkeqesimit të rrugëve dhe hekurudhave.

Plani i Menaxhimit të Trafikut përditësohet rregullisht, bazuar në metodat e ndërtimit dhe kërkesat e lëvizjes së automjeteve dhe makinerive të punës.

Objektivat specifike të këtij plani përfshijnë:

- Marrëveshjet e hyrjes në brezin e punimeve;
- Identifikimi i ndjeshmërive kryesore përgjatë rrugëve të propozuara të hyrjes dhe shërbimit;
- Identifikimi dhe ndërtimi i të gjitha rrugëve lidhëse/ndihmese dhe të shërbimit;
- Masa zbutëse për të minimizuar shqetësimet e trafikut;
- Masa zbutëse për të garantuar sigurinë e komuniteteve lokale, përdoruesve të rrugës dhe fuqisë punëtore;
- Kërkesat për trajnimin e punëtorëve në lidhje me sigurinë rrugore;
- Kompetenca e shoferit, mirëmbajtja e automjeteve dhe vendndodhjet e karburantit;
- Programim i aktiviteteve të ndërtimit;
- Përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi për zbatimin e këtij plani;
- Masat për ndalimin e vozitjes “jashtë rrugës”;
- Të respektohen kufijtë e shpejtësisë;
- Mënyrat dhe mjetet për të informuar komunitetin për rreziqet e trafikut;
- Inspektimi, auditimi dhe raportimi.

Plani përfshin dispozita për procedurat që lidhen me komunikimin me palët e interesuara dhe komunitetet e prekura. Konsultimet me agjencitë përkatëse qeveritare dhe autoritetet lokale duhet të identifikojnë projektet e planifikuara të infrastrukturës. Kontraktori duhet gjithashtu të konsultohet me përfaqësuesin kryesor të komuniteteve të prekura negativisht, në mënyrë që të marre masat e duhura zbutëse.

Projekti ka përcaktuar tashmë vendndodhjen dhe karakteristikat e tjera të të gjitha kalesave të nevojshme në nivel, rrugëve të shërbimit dhe nënkalimeve. Ndërtimi i rrugëve të reja të shërbimit dhe nënkalimeve duhet të paraprijë ndërtimit të elementeve të tjera të projektit, për të mos ndërprerë apo penguar qarkullimin. Ndërtimi i urave që shërbejnë si për rrugë automobilistike dhe hekurudha (Urat e Lumit Mat, Drin dhe Kir) duhet të planifikohet në koordinim me autoritetet rrugore dhe pushtetin vendor. Kohëzgjatja e ndërtimit të këtyre urave duhet të zgjasë sa më pak të jetë e mundur.

2.3.3.11 Plani i menaxhimit të peizazhit/relievit

Plani i Menaxhimit të Peizazhit synon rehabilitimin e peizazhit pasi të kenë përfunduar punimet e ndërtimit.

Plani i Menaxhimit të Peizazhit duhet të zbatohet në koordinim të ngushtë me Planin e Kontrollit të Erozionit dhe Sedimentimit dhe Planin e Veprimit të Biodiversitetit.

Plani përfshin procedurat që duhen ndjekur gjatë punimeve të restaurimit, përfshirë masat zbutëse dhe procedurat e monitorimit. Ai trajton veçmas procedurat e rehabilitimit që lidhen me fazat e Parandërtimit, Ndërtimit, Operimit dhe Rivendosjes.

Plani i Menaxhimit të Peizazhit përfshin gjithashtu aspektet vizuale të elementeve të linjës hekurudhore.

Stacionet e reja hekurudhore janë integruar në Planet e Përgjithshme të Zhvillimit Vendor dhe janë konsultuar me bashkitë, në territorin e të cilave ndodhen.

Stacionet hekurudhore, barrierat kundër zhurmës, muret dhe rrethimi i linjës hekurudhore do të marrin parasysh edhe ndikimin e tyre pamor.

2.3.3.12 Plani i menaxhimit të trashëgimisë kulturore

Plani i Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore synon të shmangë dëmtimet e mundshme në burimet e trashëgimisë kulturore. Plani merr parasysh legjislacionin kombëtar për trashëgiminë kulturore (Ligji 17/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, BERZH PR 8 (Trashëgimia Kulturore), si dhe Praktikën e Mirë Ndërkombëtare.

Plani i Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore përfshin:

- Kërkesat dhe standardet formale shqiptare, të BERZH dhe ndërkombëtare, si dhe angazhimet dhe veprimet e VNMS-së;
- Informacion mbi procedurat e arkivimit të materialit kërkimor dhe mbajtjen e të dhënave;
- Detajet e sondazheve të parandërtimit, identifikimit, ndikimeve dhe masave zbutëse për çdo vend të ri TCH dhe ICH;
- Identifikimi dhe zbutja e të gjitha burimeve të njohura të Trashëgimisë Kulturore TCH dhe ICH;
- Një procedurë e detajuar e gjetjes së rastit, e cila përfshin një pjesë të gjetjeve të rastësishme të ICH;
- Verifikimi dhe Monitorimi, duke përfshirë procedurat për identifikimin e burimeve shtesë të trashëgimisë kulturore të panjohura të pidentifikuara fillimisht duke përfshirë ICH; dhe
- Rolet dhe përgjegjësitë, duke përfshirë detaje mbi linjat e komunikimit ndërmjet menaxherëve të trashëgimisë kulturore në terren, ekipit të ndërtimit dhe organeve komunale dhe kombëtare të ruajtjes;
- Procedurat e licencimit të nevojshme për çdo punë arkeologjike dhe se si do të arrihet licencimi;
- Masa të sugjeruara mbrojtëse për burimet e njohura të Trashëgimisë Kulturore, me synim kryesor në radhë të parë parimin e shmangies dhe mbrojtjes; por edhe për pluhurin, zhurmën dhe dridhjet me konsideratë për ICH etj.

Strategjia e menaxhimit të burimeve të trashëgimisë kulturore përfshin hapat e mëposhtëm:

- Strategjia e angazhimit institucional për të përfshirë autoritetet shqiptare përkatëse në: vlerësimin e thellëuar dhe përdorimin e metodave ndërhyrëse dhe jo ndërhyrëse; zhvillimi i procedurës së gjetjeve të rastit; zhvillimi i qasjeve zbutëse të zonave specifike për vendet arkeologjike; dhe zbatimi i metodave duhura dhe të regjistruar

- Strategjia e konsultimit me komunitetin për të: informuar palët e interesuara lokale për aktivitetet e projektit; të përcaktojë kufijtë e zones së punës, hyrjen e përdoruesit, kohën e përdorimit dhe orarin e ngjarjeve të veçanta; dhe mbledhja e shqetësimeve të komunitetit.
- Procedurat e Gjetjeve të Rastit të zhvillohet dhe të zbatohen në bashkëpunim me institucionet përkatëse shtetërore (Agjencia e Sherbimit Arkeologjik). Kjo përfshin: përfshirjen e arkeologëve të licencuar para lidhjes së kontratës për të trajtuar një shpëtim arkeologjik nëse kërkohet në një gjetje të rastësishme; monitorimi i aktiviteteve të ndërtimit nga një arkeolog profesionist; ndërprerjen e punës dhe konsultimin me autoritetet përkatëse në rast të ndonjë zbulimi të ri arkeologjik.
- Programi i regjistrimit dhe monitorimit, duke përfshirë: anketimin dhe regjistrimin para ndërtimit; mbrojtja nga ndotja dhe dridhjet e vendeve të njohura të trashëgimise kulturore; Përdorimi i teknikave të ndërtimit me ndikim të ulët pranë vendeve të rrezikuara nga aktivitetet e projektit; përgatitjen para ndërtimit të specialisteve restaurues në rast dëmtimi aksidental të trashëgimise kulturore; dhe monitorimi periodik i zonës gjatë aktiviteteve të Projektit.

Plani do të përfshijë dispozita për trajnimin e të gjithë punëtorëve, si dhe procedura mbi komunikimin me palët e interesuara dhe mundësitë e përmirësimit të kushteve të jetesës së komunitetit.

2.3.3.13 Plani i menaxhimit të lendeve të ndërtimit

Plani i Menaxhimit të Materialeve të Ndërtimit trajton sasinë dhe llojin e materialeve ndërtimore dhe ndikimet e mundshme përdorimi i këtyre materialeve. Plani do të rekomandojë procedura të praktikave të mira për të siguruar menaxhimin e duhur të materialit ndërtimor.

Plani përfshin procedurat për menaxhimin dhe zbutjen e ndikimeve që mund të lindin nga nxjerrja, transportimi dhe menaxhimi i materialit ndërtimor. Këto ndikime mund të përfshijnë:

- Ndotja e ajrit;
- Zhurma dhe dridhjet;
- Ndikimet në biodiversitet dhe habitatet e cenueshme;
- Ndikimet vizuale;
- Ndotja e ujit;
- Menaxhimi i mbetjeve;
- Kontroll dhe menaxhim i përkohshëm i trafikut;
- Kontrolli i erozionit dhe sedimentit; etj.

2.3.3.14 Plani i menaxhimit të mbetjeve

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve synon reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazave të zbatimit të Projektit, kudo ku dhe kur është e mundur. Plani merret me menaxhimin e mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme, përfshirë mbetjet e rrezikshme, për të shmangur çdo shkarkim në tokë ose ujë. Ai përcakton procedurat për ruajtjen, grumbullimin dhe asgjësimin e mbetjeve.

Plani i Menaxhimit të Mbetjeve duhet të hartohet përpara fillimit të çfarëdo aktiviteti. Ai duhet të jetë në përputhje me Direktivat e BE-së, legjislacionin shqiptar, kërkesat PR3 të BERZH-it dhe praktikave të tjera më të mira ndërkombëtare.

Objektivi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve është të shmangë/reduktojë ndikimin e mbetjeve të krijuara gjatë aktiviteteve të ndërtimit nëpërmjet strategjisë së mëposhtme:

- Minimizimi i sasisë së mbetjeve të krijuara;
- Maksimizimi i sasisë së mbetjeve që rikuperohet për riciklim- duke përfshirë ndarjen e mbetjeve të riciklueshme në burim;
- Depozitimi i mbetjeve në përputhje me hierarkinë e menaxhimit të tyre; dhe
- Magazinimi dhe transferimi i mbetjeve të rrezikshme në objektet e duhura, në koordinim me institucionet përgjegjëse vendore/kombëtare dhe në përputhje me rregulloret e BE-së, kombëtare, BERZH-it dhe praktikave më të mira.

Meqenëse menaxhimi i mbetjeve është një proces i vazhdueshëm, Plani përditësohet gjatë gjithë fazës së parandërtimit dhe ndërtimit. Ky plan përfshin gjithashtu dispozita për trajnimin e fuqisë punëtore dhe personelit teknik, si dhe për procedurat që lidhen me komunikimin me palët e interesuara dhe komunitetin e prekur.

Projekti teknik ka marrë tashmë parasysh minimizimin e prodhimit të mbetjeve dhe, në përgjithësi, ripërdorimin e materialit mbushës të trupit të hekurudhes dhe mbetjet e betonit që do të dalin nga prishja e disa prej urave ekzistuese.

2.3.3.15 Plani i parandalimit të ndotjeve dhe reagimit në rast ndotjeje

Plani i Parandalimit të Ndotjes do të marrë parasysh të gjitha rregulloret përkatëse kombëtare dhe kërkesat e BERZH-it në lidhje me parandalimin e ndotjes. Ai përfshin çështjet e mëposhtme:

- Materialet e rrezikshme: karburantet, vajrat, yndyrat:
 - Masat e përgjithshme që kanë të bëjnë me praktikave të mira të trajtimit të materialeve gjatë fazës së ndërtimit;
 - Zëvendësimi i produktit: Nëse është e mundur, të përdoren materiale ndërtimi miqësore me mjedisin; dhe
 - Materiale të ndaluara: Mos përdorni materiale ndërtimi të ndaluara ose kimikate të rrezikshme ose toksike.
- Ndotja e ajrit nga pluhuri dhe shkarkimet e gazta; dhe
- Zhurma dhe dridhjet nga aktivitetet e Projektit

Për sa i përket lendeve të rrezikshme, do të merren parasysh sa vijon:

- Miratimi i praktikave specifike të produktit në lidhje me aspektet e mëposhtme:
 - Lëndët djegëse, vajrat dhe yndyrat: monitorim i automjeteve dhe pajisjeve të ndërtimit për rrjedhje;
 - Mirëmbajtja e rregullt e makinerive të punës dhe transportit për të reduktuar mundësinë e rrjedhjeve;
 - Ruajtja e karburanteve, vajrave dhe yndyrave në kontejnerë të përshtatshëm;

- Plehrat: Përdorimi sa më pak i plehrave për punimet e ri-mbjelljes. Ruajtja e plehrave në kosha të përshtatshme;
- Bojrat: Ruajtja dhe asgjësimi i duhur i bojrave në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.
- **Izolimi i materialeve të rrezikshme** në kontejnerë të mbyllur të përshtatshëm. Në rast sasive të madhe lëndesh të tilla, të përgatet një zonë të mbuluar që izolon rrjedhjet e mundshme.
- **Parandalimi i derdhjeve aksidentale.** Plani duhet të përcaktojë çështjet e mëposhtme:
 - Përgjegjësitë: Të përcaktohen përgjegjësinë e të gjithë punonjësve dhe kontraktorëve për të marrë masat e duhura për parandalimin e derdhjeve, në dhe për të raportuar menjëherë çdo derdhje të zbuluar të mbikëqyrësi i tyre;
 - Masat për parandalimin e derdhjeve: Përshkrimi i kushteve për ruajtjen e sigurt të lëngjeve të rrezikshme, përfshirë masat fizike, procedurat, auditimin, inspektimet dhe vlerësimin e rrezikut;
 - Raportimi: Regjistrimet, procedurat e raportimit dhe njoftimit duhet të mbahen nga ekipi i HSE në terren;
 - Veprimet dhe masat për të parandaluar rrjedhjet dhe derdhjet dhe për të mundësuar reagim efektiv ndaj çlirimeve të paplanifikuara të lëngjeve, si karburantet, vajrat, yndyrat dhe kimikatet.

Për sa i përket cilësisë së ajrit dhe zhurmës, plani duhet të përfshijë:

- Si pjesë e Planit për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Ndotjes, të përgatitet menaxhimi i cilësisë së ajrit, duke detajuar konceptin për menaxhimin e kontrollit të emetimeve nga makineritë e ndërtimit dhe transportit.
- Si pjesë e Planit për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Ndotjes, të përgatitet menaxhimi i emetimeve të zhurmës dhe dridhjeve, duke detajuar konceptin për menaxhimin e zhurmës dhe dridhjeve të krijuara nga makineritë e ndërtimit dhe transportit.

Plani i Parandalimit të Ndotjes do të përfshijë dispozita për trajnimin e punëtorëve dhe procedurat e komunikimit me palët e interesuara dhe mundësitë e përmirësimit të komunitetit në lidhje me parandalimin e ndotjes dhe mbrojtjen e mjedisit.

Plani i Parandalimit të Ndotjes është i një rëndësie të vecante për projektin e propozuar. Zbatimi i rreptë i tij do të shmangë çdo ndotje eventuale të tokës dhe ujërave nëntokësore e sipërfaqësore, përfshirë liqenin e Shkodrës dhe akuiferët që shërbejnë për furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë së qendrave të banuara që përshkohen nga linja hekurudhore e më tej.

2.3.3.16 Plani i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë së popullatës vendore

Plani i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Komunitet synon të shmangë ose minimizojë rreziqet dhe ndikimet e mundshme në shëndetin dhe sigurinë e komunitetit lokal gjatë aktiviteteve të projektit. Për më tepër, ai synon të sigurojë që mbrojtja e projektit, personelit të lidhur me të, të respektojnë rregulloret në lidhje me sigurinë dhe sigurinë e komuniteteve lokale.

Plani i Menaxhimit të Shëndetit në Komunitet përfshin:

- Kuadri ligjor, PR4 e BERZH-it dhe Politikat dhe Strategjitë kombëtare në lidhje me Shëndetin dhe Sigurinë e komunitetit (H&S) dhe të drejtat e lidhura me to;
- Nëse është e nevojshme, të behet marreveshje paraprake me institucionet shëndetësore për kujdes shëndetësor në situata emergjente;
- Ndërgjegjësimi dhe angazhimi i palëve të interesuara për H&S – Të ofrohen qasje, aktivitete dhe përshkrim të materialeve për angazhimin dhe konsultimin e palëve të interesuara;
- Marrja e masave për të parandaluar hyrjen në zonat e punës dhe mjeteve të punës, dhe pajisjeve të punës. Të menaxhohet sjellja e personelit të sigurisë;
- Të ndërtohen Mekanizma për ankesat e punëtorëve dhe komunitetit për vlerësimin e rreziqeve dhe ndikimeve të mundshme në shëndetin, sigurinë dhe sigurinë e komunitetit;
- Monitorimi i ecurisë së problemeve shëndetësore dhe sigurisë së punëtorëve. Pasqyrimi i këtyre problemeve nepermjet mekanizmit të ankesave dhe përgjigjeve.

2.3.3.17 Plani i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë

Plani i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë synon të krijojë kushtet për aktivitete të sigurta që mbrojnë shëndetin e njeriut, mjedisin dhe asetet materiale. Ai përfshin aspektet në vijim:

- Planifikimi i aspekteve shëndetësore dhe Sigurisë në punë;
- Hetimi i Aksidenteve dhe Incidenteve; dhe
- Auditimi i shëndetit dhe sigurisë.

Plani përfshin çështjet e mëposhtme:

- Identifikon rreziqet e mundshme dhe vlerëson rreziqet që lidhen me aktivitetet e projektit;
- Përkrahet strategjitë e përgjigjes dhe organizimin e menaxhimit;
- Përcakton strategjitë e komunikimit për të menaxhuar ndikimet e çdo incidenti të mundshëm;
- Përcakton rolet dhe përgjegjësitë e stafit kyç të përfshirë në projekt;
- Merr parasysh syandartet për fuqinë punëtore dhe trajnimin e stafit;
- Përcakton procedurat e njoftimit të brendshëm dhe të jashtëm, komunikimin me komunitetin, skemat organizative të përgjigjes, burimet e kontraktuesit dhe personelin;
- Procedurat e komunikimit me palët e interesuara dhe komunitetet e prekura

2.3.3.18 Plani i menaxhimit të punës dhe kushteve të punës

Plani i Menaxhimit të Punës dhe Kushteve të Punës trajton rreziqet e mundshme mbi të drejtat e punëtorëve, standardet e punës dhe shëndetin dhe sigurinë, duke përmbledhur pritshmëritë dhe procedurat për të ruajtur cilësinë e kushteve të punës, aktivitetëve dhe kodit të sjelljes.

Plani i Menaxhimit të Punës dhe Kushteve të Punës përfshin:

- Kuadrin ligjor dhe Politikat dhe Strategjitë mbi Shëndetin dhe Sigurinë dhe të Drejtat e Punëtorëve, bazuar në PR2 të BERZH-it, ligjin përkatës shqiptar dhe standardet e tjera ndërkombëtare (standardet e punës së ILO, etj.);
- Kushtet shendetesore dhe të sigurisë duhet të jenë në përputhje me ligjin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare;
- Qasjen dhe procedurat për një mekanizëm efektiv ankesash nga ana e punëtorëve;
- Qasjen për të monitoruar dhe përmirësuar gjendjen e shëndetit e sigurisë në punë, si dhe të drejtat e punëtorëve; dhe
- Qasjen për të monitoruar dhe përmirësuar mekanizmin e ankesave të punëtorëve dhe trajtimin korrekt të këtyre ankesave, përfshirë përgjigjen në kohë.

2.3.3.19 Plani i Menaxhimit të Zinxhirit të Furnizimit

Plani i Menaxhimit të Zinxhirit të Furnizimit synon të rrisë prokurimet lokale dhe të mbështesë krijimin e një zinxhiri furnizimi lokal që mund të ofrojë produktet dhe shërbimet e nevojshme. EPC/Kontraktori Primar do t'i kërkohet të zhvillojë një ESMS, ose ekuivalent, për ndërtimin e Projektit bazuar në kërkesat e ESMP.

PMZF përfshin:

- Kërkesat M&S brenda kritereve për listën e ngushtë dhe përzgjedhjen e nënkontraktorëve.
- Vlerësoni rrezikun e përdorimit të punës së fëmijëve dhe punës së detyruar në operacionet e furnizuesve kryesorë;
- Sigurohuni që klauzolat për moshën minimale, punën e detyruar dhe shëndetin dhe sigurinë të përfshihen në dokumentet e prokurimit në zinxhirin primar të furnizimit si pjesë e projektit ESMS.
- Rishikimi / auditimi i të gjithë nënkontraktorëve dhe furnizuesve të palëve të treta për të verifikuar përshtatshmërinë e tyre për të përmbushur detyrimet e E&S përpara kontraktimit.
- Zbatimi i aktivitetëve për të rritur prokurimin lokal dhe për të mbështetur krijimin e një zinxhiri furnizimi lokal;
- Identifikoni kompanitë lokale të afta për të ofruar mallra, materiale dhe shërbime;
- Vendosja e një mekanizmi për kontrollin e pranisë/mungesës së punës së fëmijëve, punës së detyruar dhe rreziqeve të larta të çështjeve të rëndësishme të sigurisë, në prodhimin e materialeve dhe pajisjeve bazë.

2.3.3.20 Plani i veprimt në rast emergjence

Plani i Veprimt/Reagimit Emergjent, përfshin veprimet dhe procedurat specifike në rast emergjence gjatë aktivitetëve të ndërtimit dhe funksionimit. Ai synon të parandalojë ndikimet e mundshme

negative në rast aksidentesh dhe gjendjeje emergjente. Ky parandalim bazohet në Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it, rregulloret kombëtare, si dhe praktikën e tjera. Plani duhet të identifikojë dhe parandalojë risqet dhe aksidentet kryesore, dhe të shmangë/zvogëlojë ndikimet e tyre negative në mjedisin biofizik dhe socio-ekonomik.

Plani do të trajtojë incidentet dhe përgjigjet/reagimin ndaj tyre, mbështetur në:

- Identifikimin e risqeve gjatë aktiviteteve të projektit, dhe të ndikimeve të tyre në mjedis dhe shëndetin e njeriut;
- Identifikimi i autoriteteve kombëtare dhe aktorëve të tjerë të fushës, dhe procedurave të duhura për të komunikuar/ndervepruar/bashkëpunuar me ta;
- Identifikimi i masave të nevojshme për reduktimin e ndikimeve të demshme në mjedis dhe shëndet nga aktivitetet e projektit. Në këtë rast të zbatohet ligji shqiptar 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, si dhe legjislacioni i BE-së;
- Përshkrimi i masave teknike për mbrojtjen e mjedisit njerëzor dhe natyror nga rreziqet e mundshme;
- Nxjerrja e mesimeve nga incidentet dhe aksidentet hekurudhore, në të kaluarën;
- Përshkrimi i strukturës organizative dhe përshkrimi i ndërveprimeve midis projektit dhe procedurave operative;
- Identifikimi i sistemit dhe procedurave për sigurimin e jetes së personelit, evakuimit, operacioneve të shpëtimit të sigurimit të jetes, dhe trajtimin e duhur shëndetësor;
- Përshkrimi i aktiviteteve të trajnimit dhe organizimi i ekipeve të trajnimit ndaj reagimeve në rast emergjence. Testimi i sistemeve dhe procedurave emergjente; dhe
- Standartet për trajnimin e të gjithë punëtorëve mbi procedurat e reagimit emergjent. Standartet për informimin dhe nderlidhjen/komunikimin e brendshëm e të jashtëm në rast emergjence.

2.3.3.21 Plani i Menaxhimit të Sigurisë

Plani i Menaxhimit të Sigurisë (SMP) synon të sigurojë dhe promovojë mjedisin fizik sa më të sigurt gjatë zbatimit të projektit. Qëllimi kryesor i këtij plani është të përshkruajë se si Kontraktori EPC do të sigurojë dhe mirëmbajë një mjedis fizik të sigurt, të përcaktojë masat e duhura të sigurisë për projektin, të sigurojë që personeli, pajisjet dhe mjetet e tjera të jenë në vend, si dhe të menaxhojë aktivitetet e stafit. Për të reduktuar rreziqet e dëmtimit personal, humbjes së pronës dhe çdo ndikimi negativ në komunitetet lokale.

Plani do të përfshijë:

- Rolet dhe përgjegjësitë e marrëveshjeve të sigurisë
- Procedurat e sigurisë (identifikimi i personelit të kontraktorit dhe kompanisë, identifikimi i vizitorëve, identifikimi i automjetit, etj.)
- Marrëveshjet e komunikimit të lidhura me sigurinë;
- Ndërfaqja me agjencitë qeveritare dhe forcat e sigurisë publike;
- Dispozitat për të siguruar pajtueshmërinë me rregulloret dhe praktikën e mira të industrisë në lidhje me:

- Përzgjedhja dhe punësimi i personelit të sigurisë
- Rregullat e sjelljes së personelit të sigurisë;
- Trajnimi dhe pajisjet e personelit të sigurisë;
- Monitorimi i përputhshmërisë dhe procesi i hetimit të akteve të mospërputhjes
- Program trajnimi për sigurinë duke përfshirë:
- Modulet e Kodit të Sjelljes specifike për personelin e sigurisë;
- Parimet Vullnetare mbi Sigurinë dhe të Drejtat e Njeriut
- Mekanizmi i ankesave

3 Plani i Monitorimit të Mjedisit

3.1 Linjat kryesore të Planit të Monitorimit të Mjedisit

Përgatitja e Planit të Monitorimit të Mjedisit për fazat e projektimit, ndërtimit dhe funksionimit të një projekti, është detyrim për të marre lejen mjedisore. Teknikat, standardet dhe metodat e përzgjedhura të monitorimit duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, europiane dhe/ose shqiptare. VKM 912/2015, “Për metodologjinë e VNM” kërkon përgatitjen e një programi monitorimi, ndërsa ligji 10431/2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, parashikon që mjediset pritës/receptorët mjedisorë të monitorohen gjatë fazave të zhvillimit të projektit. Sipas nenit 41 të këtij ligji, lista e këtyre receptorëve përfshin:

- cilësinë e ujërave sipërfaqësore;
- cilësinë e ujërave nëntokësore;
- cilësinë e ajrit;
- mbetjet;
- zhurmat;
- rrezatimi;
- cilësinë e tokës;
- flora, fauna, Biodiversiteti, pyjet;
- ndikimi i sektorëve ekonomikë në mjedis;
- monitorimin e dukurive natyrore dhe ndikimin e tyre të mundshëm në mjedis; dhe
- monitorimin e ndikimeve të ndotjes së mjedisit mbi shëndetin e njeriut.

Kjo listë nuk përfshin asnjë mjedis pritës/receptor social dhe kulturor, që i nënshtrohet rregulloreve të tjera, si ligji “Për trashëgiminë kulturore”, ligji 8561/1999 “Për shpronësimet dhe marrjen e përkohshme të pronës private për interes publik”, PRs e BERZH, etj.

4 Veprimtaritë Kryesore të Planit të Menaxhimit e Monitorimit të Mjedisit

4.1 Masat kryesore për zbutjen e ndikimeve në mjedis

Në tabelat 3.1 dhe 3.2 jepen masat kryesore zbutëse gjatë fazave të para ndërtimit e ndërtimit (tabela 3.1), dhe të funksionimit e mirëmbajtjes (tabela 3.2).

Këto masa u hartuan gjatë përgatitjes së VNM-se, nisur nga standardet e BERZH, kombëtare, praktika me e mire, dhe kushtet e tanishme të mjedisit e ndërhyrjet e parashikuara nga projekti.

4.2 Aktivitetet kryesore monitoruese

Në tabelat 3.3 dhe 3.4 jepen aktivitetet kryesore të monitorimit gjatë fazave të para ndërtimit e ndërtimit (tabela 3.3), dhe të funksionimit e mirëmbajtjes (tabela 3.4).

Këto masa u hartuan gjatë përgatitjes së VNM-së, nisur nga standardet e BERZH, kombëtare dhe të BE-së, dhe kushteve të tanishme të mjedisit e ndërhyrjeve të parashikuara nga projekti.

Tabela 4.1_Përmbledhje e masave zbutëse gjate para ndërtimit, dhe ndërtimit

Treguesi mjedisor (Indikator)	PR e BERZH (EBRD's PR reference)	Çështja mjedisore/rrëziku/ndikimi (Issue/risk)	Veprimtaria/masat zbutëse (Mitigation actions/measures)	Faza e projektit (Implementation phase)	Standardet / legjislativi (Requirements)	Treguesit kryesore të zbutjes së ndikimeve (Key performance indicator)	Përgjegjësia (Responsibility)
Vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale	PR1: Vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale	Zbatimi i masave të planit të menaxhimit	<ul style="list-style-type: none"> Kontraktorit do ti kërkohet të prodhojë dhe zbatojë një Sistem të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMS), i cili plotëson kërkesat e ISO 14001 për periudhën e para ndërtimit dhe ndërtimit. Ky sistem përbëhet nga një Plan Menaxhimi Mjedisor dhe Social dhe një Plan Monitorimi Mjedisor dhe Social. Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social të Kontraktorit (PMMSK) do të përmbajë nënplanet e mëposhtme specifike: <ul style="list-style-type: none"> Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit (SEP); Kuadri i Marrjes së Tokës dhe Rikthimit të menyrës së Jetesës (PRJ); Plani i Marrjes së Tokës dhe Rivendosja menyrës së Jetesës (LARP); Plani i kontrollit të erozionit dhe sedimentimit; Plani i menaxhimit të shtrese sipërfaqesore së tokës - topsoil; Plani i Menaxhimit të Ujërave; Plani i kalimit të rrjedhave ujore; Plani i Veprimit për Biodiversitetin; Strategjia e kompensimit (offset) për Biodiversitetin; Plani i Menaxhimit të Infrastrukturës dhe Shërbimeve; 	Në të gjitha fazat e zhvillimit të projektit	PR1 e BERZH-it; Legjislativi mjedisor dhe social shqiptar	SMMS të përafuar me ISO 14001. PMMSK dhe nënplanet e M&S janë në përputhje me angazhimet e VNMS-së, PMMS, kërkesat kombëtare dhe kërkesat e BERZH zbatohen rreptësisht;	Kontraktori; Supervizori -HSH/PIU

			<ul style="list-style-type: none"> • Plani i Menaxhimit të Trafikut; • Plani i Menaxhimit të Peizazhit; • Plani i Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore; • Plani i Menaxhimit të Materialeve Ndërtimore; • Plani i Menaxhimit të Mbetjeve; • Plani për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Ndotjes; • Plani i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Komunitet; • Plani i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë; • Plani i menaxhimit të punës dhe kushteve të punës; dhe • Plani i reagimit emergjent 				
Marredheniet me popullatën vendore/komunitetin	<p>PR10: Publikimi i informacionit dhe angazhimi i palëve të interesit;</p> <p>-PR5: Blerja e tokës, kufizimet në përdorimin e tokës dhe zhvendosja e pavullnetshme;</p> <p>-PR2: Kushtet e punësimit dhe punës:</p> <p>-PR4: Shëndeti, siguria dhe siguri</p>	<p>Priten ndikime pozitive; Problemet me komunitetet;</p> <p>-Pjesëmarrja dhe Qasja në informacion dhe mekanizmi i ankesave</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza e politikave dhe procedurave të zhvendosjes; • -Berja publike e kornizës së Restaurimit të mjeteve dhe menyrës së Jetesës (PRJ); • -Konsultimi me komunitetin për strategjinë dhe zbulimin; • -Mekanizmi i ankesave; • -Takime të ndara me komunitetet e prekura indigjene (nëse ka); • -Monitorim, për të siguruar ndërgjegjësim për procesin e dorëzimit të ankesave; • -MIE do të zbatohet strategjine e komunikimit të parashikuar në SEP; • MIE-s dhe kontraktorit do të kërkohet të mbajnë lidhje të ngushtë, gjatë gjithë periudhës së ndërtimit, me përfaqësuesit e komunitetit lokal, pronarët e tokave dhe autoritetet kompetente 	Para finalizimit të strategjise mjedisore dhe socio-ekonomike;	BERZH PR2, PR4, PR5, PR10;PR 8. -Ligjet shqiptare; IFC PS dhe Udhëzimet e Përgjithshme të IFC mbi të EHS.	<p>Raportet e monitorimit dhe auditimit;</p> <p>-Raporti financiar për të vlerësuar rezultatet e investimit;</p> <p>-Proces-verbalet e konsultimeve;</p> <p>-Fletëpalosje të përditësuara për ecurinë e planit të investimeve dhe për restaurimin e</p>	Kontraktori – Supervizori -HSH/PIU

	PR 8 Trashëgimia Kulturore		Angazhimi i komunitetit për çdo ndikim në trashëgiminë kulturore.			aseteve dhe menyrës së jetesës.	
Cilesia e ajrit	PR3: Eficienca e Burimeve dhe Kontrolli dhe Parandalimi i Ndotjes; PR4: Shëndeti, siguria dhe sigurimi	Ndikime të përkohshme, të kthyeshmë, në cilësinë e ajrit lokal, për shkak të emetimit atmosferike nga aktivitetet e ndërtimit	<ul style="list-style-type: none"> Zbatimi i Planit Specifik të Menaxhimit të Materialeve të Ndërtimit; Si pjesë e Planit për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Ndotjes, të përgatet një paragraf për menaxhimin e cilësisë së ajrit, duke detajuar konceptin për menaxhimin e kontrollit të emetimeve nga makineritë e ndërtimit dhe transportit. Njoftim paraprak për palët e interesuara për emetimet kritike të pluhurit dhe gazit nga aktivitetet e Projektit; Procedurat e ndërlidhjes me komunitetin dhe ankesave publike; Praktikë e mirë ndërtimi për të parandaluar emetimet e pluhurit dhe grimcave nga nepermjet kontrollit efektiv të burimeve të mundshme të ndotjes, përfshirë: Projektimi i punimeve të dheut në menyrë të tillë që të mundësohet rivendosja e bimesisë, pas punimeve të ndërtimit; Spërkatje me ujë në rast pluhuri të dukshëm; Mirëmbajtje e makinerive/pajisjeve të ndërtimit; Kufizimi i shpejtësisë së automjeteve në rrugët/trasene me pluhur; Mbulimi i kamionëve dhe pircjve të dheut/materialeve të ndërtimit, për të parandaluar lëshimin e pluhurit; Perputhshmeria me procedurat dhe oraret e punimeve të ndërtimit; etj. 	Para fazës së parandërtimit; Parandërtimi; Ndërtimi	BERZH PR3, PR4; Udhëzimet e IFCsë (Udhëzimet për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë); Direktiva 2008/50/KE; Ligjet shqiptare	Klauzolat e praktikave më të mira të HSE në kontratat e ndërtimit për të përfshirë sigurimin e masave kundër pluhurit; Raportet e monitorimit dhe auditimit; Regjistrimet e mekanizmit të ankesave.	Kontraktori; Supervizori HSH; M. Mjedisit Agjencia Kombëtare e Mjedisit

			<ul style="list-style-type: none"> • Kryerja e punimeve tokësore pranë liqenit të Shkodrës (veçanërisht nga km 139 deri në km 140) jashtë periudhës kur zogjtë shtegtarë qëndrojnë brenda liqenit. Kjo periudhë zgjat afërsisht nga prilli deri në fund të korrikut; • Përdorimi i lëndëve djegëse, të cilat janë në përputhje me standardet zyrtare (sipas urdhresës nr. 6, datë 09.10.2007; përmbajtja e squfurit në karburantin dizel, duke filluar nga data 01.01.2011 duhet të jetë 10 mg/kg); • Monitorimi i cilësisë së ajrit në bazë të përcaktimeve të rregulloreve përkatëse, përfshirë VKM 352/2015 “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit mjedisor dhe kërkesat lidhur me disa ndotës” etj. 				
Zhurmat dhe dridhjet	PR3: Efiçienca e Burimeve dhe Kontrolli dhe Parandalimi i Ndotjes; PR4: Shëndeti, siguria dhe sigurimi	Shqetësim i banorëve në afërsi të vendeve të punimeve; Shqetësim i mundshëm dhe/ose zhvendosja e faunës	<ul style="list-style-type: none"> • Njoftim paraprak për palët e interesuara mbi aktivitetet kritike të prodhimit të zhurmave dhe dridhjeve; • Zbatim i Planit Specifik të Menaxhimit të Materialeve të Ndërtimit; • Si pjesë e Planit për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Ndotjes, të përgatit një paragraf për menaxhimin e emetimeve të zhurmës dhe dridhjeve, duke detajuar konceptin për menaxhimin e zhurmës dhe dridhjeve të krijuara nga makineritë e ndërtimit dhe transportit; • Zbatim i procedurave të ndërlidhjes me komunitetin dhe ankesave publike; • Specifikimi gjatë fazës së projektimit duhet të sigurojë që niveli i zhurmës së gjeneruar në burim të jete nën 60 dB(A); 	Projektim; Parandërtim; Ndërtim	BERZH PR3, PR4; Udhëzimet e IFCsë (Udhëzimet për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë); Direktiva 2008/50/KE; Ligjet shqiptare	Klauzolat e praktikave më të mira të HSE në kontratat e ndërtimit për të përfshirë sigurimin e masave për reduktimin e zhurmës dhe dridhjeve; Raportet e monitorimit dhe auditimit; Regjistrimet e mekanizmit të ankesave.	Kontraktori; Supervizori HSH; M. Mjedisit Agjencia Kombëtare e Mjedisit Bashkitw e prekura

			<ul style="list-style-type: none"> • Instalimi i elementeve të duhura për të reduktuar emetimin e zhurmës; • Praktikë e mirë ndërtimi për të parandaluar gjenerimin e zhurmës dhe dridhjeve që do të shkaktonin shqetesime, përfshirë: • Kompresoret e perdorur duhet të jene te modelit me reduktim zhurme, i futur ne kuti me izolim akustik; • Te shmangen zhurmat gjate shtrirjes se shinave dhe vendosjes se traversave; • Te zvogelohen zhurmat gjate shkarkimit të automjeteve; • Automjetet e furnizimit do të drejtohen në mënyrë te tille që të zvogelohet shqetësimi për banorët lokalë; • Automjetet e furnizimit do të ndalohen të presin me motorët e ndezur brenda ose afër zones se punimve; • Të gjitha pajisjet e makinerive te ndertimit do të mirëmbahen dhe funksionojnë siç duhet, në mënyrë që të shmangen shkaqet e zhurmës së tepërt; • Rrethimi i stacioneve për të reduktuar zhurmën e krijuar nga ndërtimi i tyre; • Kufizimet në periudhat e funksionimit dhe aktiviteteteve specifike të ndërtimit do të vendosen ne marreveshje midis kontraktorit dhe autoritetit vendor përkatës; • Punimet e ndërtimit gjatë natës do te lejohen vetëm kur është e nevojshme, dhe pas konsultimit me banorët vendas; 				
--	--	--	---	--	--	--	--

			<ul style="list-style-type: none"> Banorët e shqetësuar do të njoftohen dhe informohen përpara fazës së ndërtimit, kur të planifikohen punimet e ndërtimit 				
Rreziqet gjeologjike dhe toka	PR3: Eficienca e Burimeve dhe Kontrolli dhe Parandalimi i Ndotjes; PR1: Vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale	Erozioni në shtretërit e lumenjve dhe përrrenjve; Modifikimi i morfologjise se lumenjve dhe përrrenjve; Ndotja aksidentale e tokës nga mbetjet e ngurta dhe të lëngëta; Marrje e përkohshme e tokës dhe ngjeshje e shtreses sipërfaqesore; Ngjeshja e tokës; Perhapja e ndotësve brenda	<ul style="list-style-type: none"> Plani i kontrollit të erozionit dhe sedimentimit; Plani i kalimit të rrjedhave ujore për çdo vendkalim lumi apo perroi kryesor; Plani i Menaxhimit të Materialeve të Ndërtimit; Plani i menaxhimit të shtreses sipefaqesore/vegjetale te tokës (top soil); Plani i Menaxhimit të Mbetjeve dhe monitorimi i zbatimit të tij; Procedura e Menaxhimit të Materialeve të Rrezikshme; Plani për parandalimin e ndotjes dhe monitorimi i zbatimit të tij; Procedurat e ndërlidhjes me komunitetin dhe ankesave publike; Praktikë e mirë ndërtimi për të parandaluar rreziqet gjeologjike dhe përkeqësimin e kushteve të truallit dhe masat e mëposhme: Të merren parasysh punimet mbrojtëse në shtretërit e lumenjve dhe shtretërve të përrrenjve gjatë fazës së projektimit. Të kihet parasysh modeli gjeoteknik dhe veçoritë sizmike të truallit, etj., gjatë projektimit; Heqja e shtreses sipefaqesore dhe largimi i saj nga zona e punimeve duhet të shmanget aty ku shtresa sipefaqesore konsiderohet se ka vlera në lidhje me habitatin dhe produktivitetin bujqësor, dhe aty ku do të përdoret për qëllime restaurimi; Aty ku demtohet pylli për brezin e punimeve, do të ndërmerret rimbjellje e përshtatshme (në 	Projektim; Parandërtim; Ndërtim	BERZH PR1, PR3; Ligjet Shqiptare; FAO: Klasifikimi i cilesise (land capability) së tokës; Praktika më e mirë ndërkombëtare	Raporti mbi monitorimin fillestar të Procedurave të nënkontraktorit; Raporti mbi monitorimin fillestar të listes së materialeve të nënkontraktorëve; Rezultatet e auditimeve (zbatimi i masave zbutëse); Raporti mbi zbatimin e Planit të Menaxhimit të Ujit; Raport mbi zbatimin Planit të Menaxhimit të Mbetjeve; Raporti mbi zbatimin e Planit të Menaxhimit të materialeve të rrezikshme;	Kontraktori; Supervizori HSH

		<p>profilin të tokës.</p>	<p>përputhje me kushtet ekologjike) për të zvogeluar erozionin nëpërmjet humbjes së efektit lidhës të shtresës sipërfaqësore të tokës;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Grumbullimi i përkohshëm i dheut të gërmuar do të bëhet në vende të sigurta, ku nuk ka rrezik erozioni. Çdo grumbull dheu i mbetur në fund të ndërtimit do të hiqet. Mbetjet e betonit ose mbetjet e tjera të ngurta, do të hiqen; • Masat të vecanta mbrojtëse kundër erozionit në rrjedhat e ndjeshme ujore (lumenjtë Mat e Kir dhe Perroi i Thate); • Aktivitetet për restaurimin dhe rimbjelljen e tokës do të fillojnë menjëherë pas përfundimit të punimeve, përfshirë rimbjelljen me specie vendase. Do të kryhet monitorimi derisa mbulesa bimore të jetë e qëndrueshme; • Lëvizjet e automjeteve jashtë rrugëve do të kufizohen për të ulur ndikimin e ndërtimit në humbjen e shtresës mbulesore të tokës dhe ngjeshjen se saj, veçanërisht në zonat me depozitime të shkrifeta. Kontraktori do të jetë përgjegjës për planifikimin e punimeve të ndërtimit, në mënyrë që të shmangët ndërtimi i rrugëve hyrëse gjatë periudhave me reshje të dendura; • Instalimi dhe mirëmbajtja e masave të kontrollit për erozionin, rrjedhjen dhe sedimentimin në terrene të pjerrëta (km 139 deri në km 140) dhe në zonat e prirura nga erozioni (lumenj dhe shtretër përrenjsh); • Sigurimi i pajisjeve për evakuimin e rrjedhjeve; 			<p>Procedura dhe Plani i Parandalimit të Ndotjes; Raport mbi metodat e ndërtimit në çdo vendkalim lumor; Të dhënat që verifikojnë restaurimin dhe masat e kontrollit të erozionit; Raporti i përdorimit të shtresës sipërfaqësore të tokës së hequr (top soil), të cilësisë së lartë bujqësore; Sasia dhe përbërja e argjilës së përdorur për shpimet gjeoteknike; Krahasimi i fotove para dhe pas punimeve në kalimet lumenjve dhe përrenjve kryesore.</p>	
--	--	---------------------------	---	--	--	--	--

			<ul style="list-style-type: none"> Argjila e përdorur nga sondat e shpimit, gjatë fazave të projektimit dhe ndërtimit, do të jetë jo toksike; Autobotet e karburanteve, për furnizimin e makinerive të ndërtimit, do të ketë pajisjet e duhura për të shmangur pikimet/derdhjet. Stafi do të stervitet dhe përditësohet rregullisht për përdorimin e tyre; Përpara çdo ndërtimi në zona të ndjeshme gjeologjike, kontraktori duhet të sigurohet (nga studimi gjeoteknik) që nuk ka rrezik të mundshëm që lidhet me punimet nëntokësore; Masat zbutëse, specifike për çdo zonë ndërtimi, do të zhvillohen më tej para se të fillojë ndërtimi, përmes dokumenteve të duhura teknike. 				
Burimet ujore	PR3: Efiçienca e Burimeve dhe Kontrolli dhe Parandalimi i Ndotjes; PR1: Vlerësimi dhe menaxhimi i rreziqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale	Ndikim në ujërat sipërfaqësorë nga sedimentet e ndotura; Ndotje aksidentale e ujërave të ëmbla nga mbetjet e ngurta dhe të lëngshme; Modifikimi i morfologjisë së shtratit të	<ul style="list-style-type: none"> Plani i menaxhimit të ujit dhe monitorimi i tij; Plani i kalimit të rrjedhave ujore për çdo vendkalim; Plani për parandalimin dhe reagimin ndaj derdhjeve; Plani i Menaxhimit të Materialeve të Ndërtimit; Plani i Menaxhimit të Mbetjeve dhe monitorimi i zbatimit të tij; Procedura e Menaxhimit të Materialeve të Rrezikshme; Plani për parandalimin e ndotjes dhe monitorimi i zbatimit të tij; Plani i kontrollit të erozionit dhe sedimenteve; Procedurat e ndërlidhjes me komunitetin dhe ankesave publike; Masat specifike në vendkalimet e rrjedhave ujore; 	Projektim; Parandërtim; Ndërtim	BERZH PR1, PR3; Direktiva Kuadër për Ujërat (WFD); Direktiva e BE-së 78/659 për cilësinë e ujit për të mbështetur jetën e peshqve; Direktiva e BE-së 76/160 për cilësinë e ujërave për larje;	Raporti mbi monitorimin fillestar të Procedurave të nënkontraktorit; Rezultatet e auditimeve (zbatimi i masave zbutëse); Raporti mbi zbatimin e Planit të Menaxhimit të Ujit; Raport mbi zbatimin e	Kontraktori; Supervizori HSH; M. Mjedisit Agjencia Kombëtare e Mjedisit Bashkitw e prekura Agjensite për ujin

		<p>lumenjve e perrenjve; Harxhimi i rezervave të ujërave të ëmbla</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Masat specifike mbi akuiferët e zones së projektit (Kalimi i shtratit të lumit Mat nga km 55 në km 56); • Masat specifike mbi Akuiferin Kuaternar të Shkodrës (nga km 107 në km 108); • Masat specifike mbi akuiferin gëlqeror (nga km 130 në km 140); • Restaurimi i brigjeve dhe shtretërve të lumenjve dhe monitorimi i punimeve restauruese; • Praktika e mirë ndërtimore për të parandaluar ndotjen e ujit, duke përfshirë: • Kampe pune në distancën e duhur nga ujërat sipërfaqësore; • Minimizimi i përdorimit të ujërave nëntokësore, dhe përdorimi i ujërave nëntokësore me ndjeshmëri të ulët; • Miratimi i masave që shmangin ose reduktojnë përdorimin e ujit në mënyrë që konsumi i ujit të projektit të mos ketë ndikime negative të rëndësishme në burimet ujore: përdorimi i masave shtesë teknikisht të realizueshme për ruajtjen e ujit në kuadër të aktiviteteve të ndërtimit; përdorimi i furnizimeve alternative me ujë, kompensimi i konsumit të ujit për të reduktuar kërkesën totale për burime ujore brenda furnizimit të disponueshëm; • Të zhvillojë dhe zbatojë procedura për përdorimin e ujit (monitorimi dhe kontrolli i sasisë dhe cilësisë) • Të minimizohet, kur është e mundur, puna në terren të butë, në mot të lagësht; 		<p>UNECE: Udhëzime për kategorizimin e ujërave të lumenjve bazuar në treguesit e tyre të cilësisë; Ligjet shqiptare</p>	<p>Planit të Menaxhimit të Mbetjeve; Raporti mbi zbatimin e Planit të Menaxhimit të materialeve të rrezikshme; Procedura dhe Plani i Parandalimit të Ndotjes; Raporte për punimet restauruese në çdo vendkalim; Vëllimet e ujit të përdorur; Sasia dhe përbërja e argjilës së përdorur për shpimet gjeoteknike; Përqendrimet e turbulltisë/lëndëve të ngurta, vajrave, karburanteve, grasove, etj., të matura në burimet ujore para dhe pas ndërtimit;</p>	
--	--	---	---	--	---	--	--

			<ul style="list-style-type: none"> • Nuk do të ketë shkarkim ujërash të ndotura drejtpërdrejt në ujërat sipërfaqësore ose nëntokësore; • Masa për parandalimin e rrjedhjes së sedimenteve nga zonat e punimeve në rrjedhat ujore; • Të ndalohet grumbullimi i materialit të germuar jashtë kantierëve. Të shmangen zonat afër rrjedhave ujore për grumbullimin e këtij materiali; • Sigurimi i pajisjeve për evakuimin e rrjedhjeve; • Autobotet e karburanteve, për furnizimin e makinerive të ndërtimit, do të ketë pajisjet e duhura për të shmangur pikimet/derdhjet. Stafit do të stervitet dhe përditësohet rregullisht për përdorimin e tyre; • Mirëmbajtja e rregullt e të gjitha makinerive për të parandaluar rrjedhjet e vajrave dhe karburantit; • Ndalohet kalimi i rrjedhave ujore nga automjetet dhe makinerit; • Argjila e përdorur nga sondat e shpimit, gjatë fazave të projektimit dhe ndërtimit, do të jetë jotoksike. 			<p>Ndjeshmëria e akuiferëve të përshkuar; Krahasimi i fotove para dhe pas, në vendkalimet kryesore të lumenjve.</p>	
Mjedisi biologjik	PR6: Ruajtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore të gjalla;	Restaurimi i habitateve; Humbja/degradimi i habitatit, copëzimi, i drejtpërdrejtë	<ul style="list-style-type: none"> • Veprime të përgjithshme – praktikë e mirë ndërtimi; • Zhvillimi i një Plani Veprimi për Biodiversitetin (PVB BAP) për zonën me shkurre dhe pyll, në pjesën veriore të linjës hekurudhore (km 132.6 deri në km 137+750). BAP duhet të jetë pjesë e procesit të tenderimit; 	Projektim; Parandërtimi; Ndërtimi; Pas ndërtimit	PR 6 e BERZHit; Konventa e Bernës; Konventa për ruajtjen e kafshëve të egra evropiane dhe	Regjistrime që vertetojnë zbatimin e masave zbutëse; Monitorimi i veprimtarisë restauruese në brezin e punës;	Kontraktori; Supervizori HSH; M. Mjedisit Agjencia Kombëtare e Mjedisit AKZM & ARZM;

